

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7563 E hënë 18 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* Ditës

Pirateria dixhitale është një fenomen prej kohësh problematik në tregun jo vetëm online. Shifrat në humbje të kompanive të mëdha dhe serioze, të cilat...
Vijon në faqen 21

Nga MONIKA STAFA

Pirateria dixhitale, sprova jonë e radhës



Dje *në* "Deutsche Welle"



Politika për dhënien e azilit është një nga temat më të diskutueshme nga partitë në parlamentin gjerman, Bundestag. Sa refugjatë lejohen të hyjnë në ...
Vijon në faqen 22

Nga CARLA BLEIKER

E drejta e azilit në BE: Faktet më të rëndësishme



Nëna e 2 fëmijëve tentoi të ikte pas krimit

Gruaja vret me 4 plumba burrin: Ishte xheloz, më rrihte vazhdimisht

Milot, 35-vjeçarja qëllon ndaj bashkëshortit. Fjalët para arrestimit: "Oj nanë, ç'bëra unë"

INA ALLKANJARI

Krimi në familje ka goditur sërish. Mëngjesin e djeshëm Miloti është tronditur pasi një 35-vjeçare ka qëlluar me armë mbi bashkëshortin e saj, duke e lënë të vdekur në vend. Ngjarja ndodhi rreth orës 07:10, në tregun ...

Në faqen 6

KUSHTET PER TE APLIKUAR NE SKEMEN E SIGURIMEVE, KUSH PERFITON

PENSIONET E FERMEREVE, ISSH: SI TE SIGUROHENI

Të vetëpunësuarit në bujqësi, dokumentacioni dhe procedurat për t'u siguruar edhe për vitet e kaluara. Kompensim të ilaçeve në rast sëmundjeje



(Në foto) Fermerë

Në faqen 8

INTERVISTA

Paloka: Qeveri antimafia. Me LSI, koalicion në momentin e duhur

Në faqen 4-5

KRYEMINISTRI

Rama: Nis Rruga e Arbrit, projekti i Saliut pa kokë. 1 miliard euro Veriut

Në faqen 3

INTERVISTA

Arqile Gjilkondi: Si kryhet mjekimi me antibiotikë i prostatitit kronik

Suplement

KOMPENSIMI

Pronat në Korçë, ATP-ja merr në shqyrtim 10 mijë dosje, ja emrat

Në faqen 11

NGA DASHNOR KALOÇI



DOSSIER

Kur Byroja Politike alarmohej për gjendjen në Teatër, ja raporti i 1973

Në faqen 18-19

Autori i krimit, djali i komandantit të Policisë Kufitare të Tivatit. Vajza ishte e kamur

Vrau të dashurën ukrainase, arrestohet i riu

Prangoset në Tiranë 22-vjeçari nga Mali i Zi. Masakroi 30-vjeçaren me thikë

Policia e Tiranës ka vënë në pranga ditën e djeshme një shtetas malazez të dyshuar për vrasje. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasin Arseni Stanović, i cili kishte hyrë ilegalisht në Shqipëri. Ai akuzohet se ka vrarë një shtetase nga Ukrai-



na, Anastasije Lašmanove. Ndërkohë, pas arrestimit në Tiranë, i riu u depërtua për në Malin e Zi, ndërsa u mor në dorë dorëzim nga shërbimet e policisë malazeze. Në 11 maj të këtij viti, Arseni Stanović 22 vjeç, dyshohet të ketë vrarë ...

Në faqen 7

MAXHORANCA LEVIZJET

PS me 76 deputetë, PDIU vetëm me një, Idrizi: Lajmet e vjetra, u shitën si të reja

Dy deputete të PDIU shkojnë te PS, Lala: U bashkohem më të mirëve

Ikën edhe Elena Xhina: Jam e pavarur

Valentina Madani

Dy deputete të Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet i bashkohen Partisë Socialiste, e cila arrin në 76 mandate ndërsa PDIU mbetet vetëm me një deputet. Bëhet fjalë për deputetën Elena Xhina të Elbasanit dhe Reme Lala të Dibrës. Lala deputetja që fitoi mandatin me PDIU-në, por që gjithmonë nuk e ka fshehur simpatinë për kryeministrin Edi Rama dhe PS-në njoftoi dje bashkimin e saj me maxhorancën. Në takimin e kryeministrin Edi Rama në Peshkopi, Lala mbajti një fjalim të gjatë ku nuk kursye elozhet për shefin e qeverisë, ministrat Xhaçka dhe Gjoknuri dhe në fund deklaroi se do i bashkohet 'më të mirëve', PS-së. "Gjithmonë zemrën peshë ke për të na e mbajtur me këto surpriza zoti kryeministër. Kjo është rruga e nderës së çdo dibrani. Gëzimi i madh sot edhe për Dibrën e Madhe, ne këtej dhe vëllezërit e motrat tona andej kufirit. Në këtë shesh, në çdo fushatë të çdo partie Rruga e Arbrit ka qenë kryefjala e premtive dhe pas çdo zgjedhjeve kryefjala e zhgënjimeve. Faleminderit Edi Rama se ma shpëtove mandatin. Por përtej shakasë bravo të goftë se për sa i përket Dibrës, i shpëtove nderin politikës, qeverisë dhe vetes", tha ajo duke përdorur fillimin e punimeve për "Rrugën e Arbrit". Sipas Lalës, Dibra është partia e saj. "Unë iu kam thënë dibranëve që unë nuk kam parti, partia ime është Dibra. Nuk bëhem pjesë e lojërave politike. Në këtë vit të parë kam mundur të shoh e të përjetoj shumë gjëra dhe kam kuptuar se nuk janë të gjithë njësoj si nga televizori. Unë dua të bashkohem



Reme Lala

Elena Xhina

SHPËTIM IDRIZI

PDIU shprehet në "Facebook", se kandidatet janë deklaruar me PS-në që në përfundim të zgjedhjeve dhe se kjo gjë nuk sjell asnjë ndryshim në veprimtarinë politike të kësaj force për çështjen çame.

"Rama, i keni shpallur luftë PD-së"

Berisha: Dekorimi i atentatorit të Azem Hajdarit, hakmarrje politike

Ish-kryeministri Sali Berisha e cilësoi dje një hakmarrje politike dekorimin e ish-deputetit Gafur Mazreku, i cili plagosi themeluesin e PD-së Azem Hajdarin në vitin 1997. Berisha shprehet se urdhri i Edi Ramës për dekorimin është një akt i pashembullt në historinë e një vendi të lirë. Për ish-kryeministrin të dekorosh njeriun që përgjaku parlamentin për herë të parë do të thotë të shkrethësh një breshëri të replumbash mbi Azem Hajdarin dhe t'i shpallësh luftë PD-së, demokratëve të mëtejshëm. "Edi Rama dekoron atentatorin e tribunit të lirisë Azem Hajdarin! Urdhri i Edi Ramës për dekorimin pas vdekjes të Gafur Mazrekut, njeriut që i shtyrë nga pushteti i atëhershëm, duke shfrytëzuar një zënkë si pretext



shkrehu në parlament breshëri plumbash mbi liderin e dhjetorit Azem Hajdarin, është një akt i pashembullt në historinë e një vendi të lirë. Me këtë vendim Edi Rama dëshmon urretjen atërore ndaj tribunit të lirisë për pushtetin e humbur të etërve të tij", shprehet z.Berisha. Sipas tij të dekorosh njeriun, kriminelin që përgjaku për herë të parë në historinë parlamentare e vendit do të thotë të shkrethësh në emër të tij breshëri të replumbash mbi gjoksin e heroit legjendar

si dhe t'i shpallësh luftë PD-së, demokratëve të Hasit, të Veriut dhe të mbarë Shqipërisë. "Me këtë vendim të pashembullt në historinë e një vendi të lirë, Edvin Kristaq Rama ndjell gjakun në parlamentin e vendit, përligj vrasjen politike, shpërblen dhe nderon për qëllime kriminale politike krimin në tërësi dhe krimin politik në veçanti! Ky akt kriminal, me të cilin Edvin Kristaq Rama shpërblen dhe nderon njeriun, që meritë të vetme ka krimin e shëmtuar të derdhjes së breshërive të plumbave në parlament mbi Prijësin e Lëvizjes Studentore të Dhjetorit 1990, themeluesin e Partisë Demokratike dhe pluralizmit politik, përbën një hakmarrje të qartë politike primitive, e cila kërkon shpërgim!", shprehet z.Berisha.

me më të mirat dhe të mirët, me PS-në që nuk është më e mira, por më të mirë nuk kemi parë", deklaroi Lala. Madje ajo shtoi se edhe Elena Xhina e pranishme në aktivitet, ka vendosur t'i bashkohet Partisë Socialiste. Kjo e fundit sqaroi në 'Facebook'

se është pjesë e një grupi të pavarur deputetësh në parlamentin e Shqipërisë. "Sot (dje) pata kënaqësinë të isha e pranishme në inaugurimin e fillimit të punimeve të Rrugës së Arbrit, në Dibër e ftuar nga mikja ime Reme Lala, të cilën e falënderoj që

më dha mundësinë që t'i bashkohesha dhe unë gëzimit të saj, për këtë ëndërr të vjetër të dibranëve! Marr shkas nga titujt e gazetave për të bërë një sqarim për opinion publik: Unë jam në grupimin e deputetëve të pavarur të parlamentit të Sh-



Nisja e punimeve dje në Rrugën e Arbrit

Meta në Kosovë ngushëllon familjen e Ili Haradinajt

Presidenti Ilir Meta, vizitoi dje familjen Haradinaj në Glogjan, ku i shprehu ngushëllimet bashkëshortes së Ili Haradinajt, për humbjen e njeriut të zemrës. Në këtë vizitë Meta ishte i shoqëruar edhe nga kryeministri Ramush Haradinaj. Pas vizitës Meta tha për mediat që të gjithë shqiptarët duhet t'i jenë mirënjohës Ili Haradinajt. "Presidenti Meta ka vizituar familjen Haradinaj në Glogjan. Meta i ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta bashkëshortes së Ili Haradinajt dhe familjarëve të tij. Më pas Presidenti Meta i shoqëruar nga kryeministri Haradinaj u shpreh për mediat. Meta vlerësoi se të gjithë shqiptarët do t'i jenë mirënjohës Ili Haradinajt që e ktheu shtëpinë e familjen e tij në një kështjellë të pamposhtur të lirisë e atdeshdshurisë", thuhet në njoftimin e presidencës.

qipërisë", shkruan znj.Xhina.

REAGIMI

Largimi i dy deputeteve të PDIU-së Reme Lala dhe Elena Xhina drejt Partisë Socialiste, ka sjellë edhe reagimin e kësaj force politike. Kreu i saj Shpëtim Idrizi ndau në rrjetin social 'Facebook' qëndrimin zyrtar të partisë ku shkruan se ky nuk është ndonjë lajm i ri dhe se deputetet janë deklaruar pro PS-së që pas përfundimit të zgjedhjeve. "Lajmet e vjetra që sot shiten si të reja, për individë që kanë qenë thjesht kandidatë të PDIU-së, sepse janë deklaruar me PS-në qysh në përfundim të zgjedhjeve, nuk sjellin asnjë ndryshim në veprimtarinë tonë politike për zgjidhjen e çështjes çame. Çështja Çame na bash-

kon dhe na ndan me këdo... si një kauzë jo vetëm e jona, po e çdo shqiptari brenda dhe jashtë kufijve", shkruhet në komunikimin zyrtar. Ndërsa më herët Reme Lala deklaroi: Unë dua të bashkohem me më të mirët, me Olta Xhaçkën dhe Lindita Nikollën. Dua të bashkohem me PS, se nuk jemi më të mirët, por më të mirë nuk kemi parë. Ajo nuk u ndal me kaq, por tha se në këtë ceremoni është e pranishme edhe Elena Xhina, deputetja çame e Elbasanit, e cila ka vendosur t'i bashkohet Partisë Socialiste. Pas këtyre dy kalimeve, që prej muajsh ishin vota të sigurta pro qeverisë, Partia Socialiste arrin në 76 mandate zyrtare. PDIU-së i nglejt vetëm një mandat, ajo e deputetit tjetër të Elbasanit, Dritan Bici.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Socialës: Rezarta Delsula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevlja SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autokatorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: www.gsh.al, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPURË NË "Klasik"Shpk



"Akt i paligjshëm kundër një deputeti"

PD: Policia dhunoi deputetin Gjunkshi gjatë protestës kundër Ramës

Teksa kryeministri Edi Rama ndodhej në qytetin e Dibrës për një takim me qytetarët, mbështetësit e Partisë Demokratike protestuan. Demokratët denoncuan dhe dhunimin nga policia të deputetit të tyre në qarkun e Dibrës, Xhemal Gjunkshi duke u penguar të protestojë gjatë takimit të kryeministrit në Peshkopi. PD akuzoi se deputeti është dhunuar teksa po protestonte bashkë me qytetarët kundër kryeministrit Rama. Sipas PD, deputeti Gjunkshi është tërhequr me dhunë nga policia duke u penguar të protestojë. "Dibranët presin me protestë Edi Ramën, që ka mbledhur administratën në ditë pushimi. Deputeti Gjunkshi ka shenja të dhunës në trup nga tërheqja e policëve. Ky është një akt i paligjshëm kundër një deputeti", deklaroi PD. Sipas Partisë Demokratike, Rama ka preferuar të lëvizë me helikopter ndërkohë që mbështetës të PD-së qëndronin me pankarta dhe thirrje kundër. "O kryemashtrues, shporru nga Klosi dhe qeveria", thuhet në parullat e qytetarëve. Po dje PD-ja reagoi pas takimeve të kryeministrit Edi Rama në qarkun e Dibrës. Sipas PD, Rama mes dhjetëra familjeve të ndershme, zgjodhi të promovonte biznesin e një familjeje në hasmëri për pazare droge.

DENONCIMI

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një video nga përplasja e policisë me qytetarët në Peshkopi gjatë kohës që mbështetës të PD-së protestonin kundër kryeministrit. Berisha tha se Rama ka nxjerrë administratën në shesh në ditë pushimi, ndërsa narkopolicia dhunon deputetin e PD.

Opozita e pret me protestë, kryeministri: Çingiet e filmit "Koncert në vitin 1936"

Nis Rruga e Arbrit, Rama: Projekti i Saliut pa kokë

"85% e paketës '1 miliard euro' për Veriun"

Kryeministri Edi Rama njoftoi dje nga Dibra nisjen e punimeve për Rrugën e Arbrit, investimi i parë i projektit 1 miliard euro. Pikërisht mesdita e 17 qershorit shënoi nisjen zyrtare të punimeve për Rrugën e Arbrit dhe pritet të përfundojë brenda tre viteve. Ky investim infrastrukturor që kap vlerën e 240 milionë eurove parashikon shkurtrimin e distancës nga Tirana në Dibër nga 180 në 69 km. Nga Bulqiza në kryeqytet rruga do të përkohet për vetëm 40 minuta dhe nga Burreli për një orë. Projekti parashikon ndërtimin e disa urave dhe tuneleve si dhe përfshin degëzimin e Maqellarës dhe Klosit. Në ceremoninë e inaugurimit të nisjes së punimeve të Rrugës së Arbrit, kryeministri Rama shpjegoi arsyet e vonesës në realizimin e këtij projekti teksa shigjetoj paraardhësin e tij në detyrë. Prania e tij në Dibër u shoqërua edhe me protestën nga ana e opozitës, të cilat kryeministri nuk nguroi t'i ironizojë, së bashku me një koment të bërë nga ish-kryeministri Berisha në rrjetet sociale. Akuzu në adresë të ish-kryeministrit Berisha për investimet në infrastrukturë, Rama bëri edhe gjatë një takimi që pati me banorët të Peshkopisë, tekta premtori kthimin e vendit në një kantier ndërtimi për investimet në infrastrukturë. "Rruga e Arbrit nuk do jetë më një iluzion, por realitet. Sapo e fitova bastin me Oltën, sepse i thashë sapo të flas unë do të fillojë shiu, sepse pa bërëqet nuk mbaron sot ky takim", deklaroi z.Rama. Kryeministri premtori se inaugurimi do bëhet para zgjedhjeve. "Këtu do të jemi, do të vijmë nga Rruga e Arbrit para se të vijmë të kërkojmë votën tuaj", tha Rama. Ai njoftoi se 85% e investimeve të paketës 1 miliard euro janë nga Tirana e lart. Shefi i qeverisë tha se rrugët e bëra nga qeveria e tij do të jenë



Kryeministri Edi Rama dje në Klos

PREMTIMI

Kryeministri Rama premtori se inaugurimi do bëhet para zgjedhjeve. "Këtu do të jemi, do të vijmë nga Rruga e Arbrit para se të vijmë të kërkojmë votën tuaj", tha Rama. Ai njoftoi se 85% e investimeve të paketës 1 miliard euro janë nga Tirana e lart.

HD dhe jo rrr si ato të demokratëve. "Kam dhe një tjetër për hajgaren, nuk pushon, veriu-veriu, Edi Rama nuk do veriuin, Edi Rama urren veriuin. E dini sa shkon në veri, nga Tirana e lart dhe sa shkon nga Tirana e poshtë nga programi 1 miliard për rindërtim që fillon me Rrugën e Arbrit? Shkon

mbi 85% nga Tirana e lart. Çfarë është veri apo ju? Natyrisht është jug po ta shohim me pozicionit e Saliut që sheh nga këtu poshtë për andej sipas interesit, por është veri. Rrugët tona do të jenë HD nuk do të jenë rrr si rrugët e Saliut", deklaroi z.Rama. Jo vetëm në Dibër, por edhe në Klos, kryeministri Edi

Rama u prit me protesta dhe thirrjet "Rama Ik" nga të rinjtë e FRPD-së. Shefi i qeverisë duke komentuar protestën e tyre teksa njoftonte punimet për Rrugën e Arbrit, i cilësoi si skena qesharake që i kujtonin çingiet e filmit "Koncert në vitin 1936". "E dini si është historia e qeverisë sime, si historia e një familje ku kryefamiljari i la të gjithë lekët në baste dhe u zhduk duke lënë të gjithë familjen në borxh. Kështu ishte shtëpia e përbashkët e Shqipërisë që na la në Sali hajgarja. I thashë atje, por do i them prapë këtu sot, për një arsye, se kur po vija këtu pashë nja 20-30 veta, ata të shkretë nuk kanë faj se kishin dhe një deputet atje në krye njësoj si çingiet e filmit "Koncert në vitin 1936". Rama ik! Rama ik! Edhe Saliu, ma çoi Olta, kishte nxjerrë fotografi: Dibra e pret me protesta narko... ku e di unë. "Koncert në vitin 1936". Vetëm se ky ja merr të keqen Albert Vërrisë se ky është 1000 herë më qesharak se roli i Albert Vërrisë dhe këto çingiet e veta janë 1000 herë më qesharake se çingjet e Albert Vërrisë që dalin nëpër cepa dhe i japin skapamentos me atë fuqinë motorike që i ka ngelur Saliut dhe iu duken ato të skapamentos sikur janë bomba", tha z.Rama.

Xhaçka: Plani i qeverisë për zhvillimin e Lurës



Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka theksoi dje se Lura është një vend që për shkak atë rrugës shumë të keqe, distancës, izolimit vizitohet shumë rrallë, madje vizitohet rrallë edhe nga politikanët vetëm në raste fushate elektorale dhe të zgjedhjeve. Ministria tha se Lura është një vend që për shkak të rrugës shumë të keqe, distancës, izolimit vizitohet shumë rrallë, madje vizitohet rrallë edhe nga

politikanët vetëm në raste fushate elektorale dhe të zgjedhjeve. Por sot, vijoi ajo, nuk kemi ardhur as për fushatë as për zgjedhje, por kemi ardhur, sepse kryeministri na ka bërë bashkë në një fushatë llogaridhënie në të gjithë Shqipërinë, jo vetëm në qendrat e bashkive

dhe njësisive administrative, por kudo ku banojnë qytetarë që ne u shërbejmë për të bërë një diskutim sy më sy e ballë për ballë me gjithsecilin për shqetësimet, nevojat për të bërë një vlerësim të punës së qeverisë në këtë mandat të dytë qeverisë.

AKSIONI OPOZITAR INTERVISTA

Zyrtari i PD: Në Europë nuk shkohet duke i fshehur problemet, por duke i zgjidhur ato

Paloka: Pas lojës kriminale të Ramës, vjen surpriza e madhe e Bashës

"Çështja 'Xhafaj', nuk është mbyllur"

Valentina Madani

PD-ja kërkon hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në pasi, sipas nënkryetarit Edi Paloka, sa më pranë saj aq më i madh është kontrolli i institucioneve europiane ndaj qeverisë shqiptare. Z.Paloka thotë për "Gazeta Shqiptare" se PD-ja ka votuar çdo ligj të kërkuar nga BE si kusht për integrimin, përfshi këtu dhe ndryshime Kushtetuese që pa votën e PD nuk mund të kalonin. Po ai kujton se kur BE kërkonte votimin e tri ligjeve kyçe për integrimin, Edi Rama nuk i votoi deri sa erdhi në pushtet. Z.Paloka flet edhe për aksionin opozitar kundër qeverisë dhe lidhjeve me krimin dhe korrupsionin. Zyrtari i lartë i PD-së paralajmëron se pas lojës kriminale të Edi Ramës së shpejt vjen dhe surpriza e madhe e Lulzim Bashës. Edi Paloka apelon për një qeveri antimafia për zhvillimin e zgjedhjeve të lira ndërsa lidhur me mundësinë e një koalicioni me LSI-në për zgjedhjet e ardhme lokale, ai shprehet se do vendoset në momentin e duhur.

Z.Paloka edhe pak ditë na ndajnë nga vendimi i BE-së për të hapur ose jo negociatat me Shqipërinë. Cilat janë pritshmëritë e PD-së në këtë rast dhe a e meriton Shqipëria një vendim pozitiv pavarësisht tri vendeve skeptike...?

Pozicioni i PD-së lidhur me hapjen e negociatave është më se i qartë. Ne kemi kërkuar dhe kërkojmë hapjen e negociatave të BE me Sh-



Nënkryetari i PD-së Edi Paloka

NEGOCIATAT

"Ne nuk mendojmë se në Europë duhet të shkojmë duke fshehur realitetin negativ, por duke e përmirësuar atë. Në Europë nuk duhet të shkojmë duke mashtruar e duke i fshehur problemet, por duke i zgjidhur ato. Ne nuk e duam Europën në letër, formalisht, si medalje për qeverinë, por duam që Shqipëria realisht të bëhet një vend evropian", -tha z.Paloka.

qipërinë.

Këtu nuk janë deklarata sa për të larë gojën e as qëndrim prej hipokritësh siç përpigjen ta paraqesin kundërshtarët tanë. Ky është një qëndrim i bazuar në bindjen tonë se sa më pranë BE-së aq më i madh është kontrolli i institucioneve europiane ndaj qeverisë shqiptare dhe hapave që ajo duhet të ndërmarrë për ta afruar realisht Shqipërinë me BE. Pozicionin tonë, ne e kemi vërtetuar me akte e jo me fjalë dhe këtu nuk e kam

fjalën për lobimin permanent të PD-së për hapjen e negociatave, por për faktin që ne kemi votuar çdo ligj të kërkuar nga BE si kusht për integrimin, përfshi këtu dhe ndryshime Kushtetuese që pa votën e PD nuk mund të kalonin. Besoj ju e kujtoni cili ka qenë qëndrimi i Ramës në raste të ngjashme, kur BE kërkonte votimin e tri ligjeve që Rama nuk i votoi deri sa erdhi në pushtet.

Por thënë këto, sigurisht ne nuk mund të pra-

SURPRIZA

"Zoti Basha e ka bërë të qartë vetë se pas lojës kriminale që po bëhet për të shpëtuar Xhafajin duke implikuar dhe prokurorinë, tashmë të kthyer në shërbim të plotë të kryeministrit, ata do të vihen përpara një surprizë të madhe lidhur me atë çështje. Duhet vetëm të presim që Rama të çojë në fund lojën e tij", - theksoi nënkryetari i PD-së.

nojmë as qëndrimin e as lojërat prej sharlatani të Edi Ramës, i cili herë përpigjet të mashtrtojë, pastaj kërcënon se do shkojë tek "të tretët" e në fund ofrohet e deklaron se është gati të bëjë gjithçka. Por kur thotë këtë nuk ka parasysht kushtet që i kërkon BE-ja, por "korrupsionin" e Europës duke i ofruar kthimin e vendit ose në kamp refugjatesh ose në vendgrumbullim plehrash. Për Ramën është më e lehtë kjo se sa të dorëzojë Tahirin dhe Xhafajin, të luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin. Sigurisht që për ne kjo nuk është e pranueshme.

Kjo është arsyeja që vazhdoni aksionin opozitar kundër qeverisë...?

Ne nuk mendojmë se në Europë duhet të shkojmë duke fshehur realitetin negativ, por duke e përmirësuar atë. Në Europë nuk duhet të shkojmë duke mashtruar e duke i fshehur problemet, por duke i zgjidhur ato.

Ne nuk e duam Europën në letër, formalisht, si medalje për qeverinë, por duam që Shqipëria realisht të bëhet një vend evropian, që shqiptarët të kenë e të shijojnë realisht standardet dhe mirëqenien e



Protesta e fundit e opozitës

Ndasitë

"Ata që janë në PD i bashkon gjithçka e nuk i ndan asgjë. Kjo nuk do të thotë

që ne nuk kemi mendime apo ide të ndryshme, që i debatojmë ato, por në fund qëllimet dhe interesat i kemi të përbashkëta.

Kush nuk ka qëllime dhe interesa të përbashkëta me PD, edhe pse mund të mbaj teserën e saj, nuk është pjesë e PD-së", -tha z.Paloka.

një vendi evropian. E për këtë kushtet janë, duhet vetëm vullnet politik. Vullnet që Ramës i mungon, sepse për të karrigia dhe xhepi i tij janë të vetmet që i interesojnë.

PD-ja ka ndërmarrë një

fushatë denoncimesh ndaj qeverisë dhe lidhjeve të saj me krimin, duke u fokusuar më tepër në çështjen "Tahiri" dhe "Xhafaj". Në këtë betejë PD-ja do të fituar para shqiptarëve apo u shndërrua në një opozitë e "pabueshme"?

Detyra e opozitës është të denoncojë dhe të luftojë për qëndrimet e saj me ato mundësi që ka. Mendoj që PD-ja rolin e saj e ka realizuar plotësisht jo vetëm për rastet e fundit, por dhe në betejat të tjera të saj të vogla dhe të mëdha. Dekriminalizimi nuk do të ishte realizuar kurrë pa betejën e opozitës. Reforma në drejtësi, pa këmbënguljen e opozitës për përfshirjen e Komisionit të Venecias (i cili i dha të drejtë PD-së për gjithë ndryshimet kushtetuese), do kishte dështuar që në fillim. Fakt është që sot, me aktet që ndërmori maxhoranca duke miratuar e vetme ligje antikushetuese, reforma ka dështuar dhe drejtësia është futur në kolaps. Ishin denoncimet e PD-së, me fakte dërrmuese, që demaskuan strategjinë e Ramës për kanabizimin e vendit dhe blerjen e zgjedhjeve me paratë e drogës, të vërteta këto të pranuaru sot ndërkombëtarisht. Mund



"Rama e ka më lehtë të kthejë vendin në kamp refugjatësh se të dorëzojë ministrat e inkriminuar"

Beteja me krimin, Paloka: Qeveri antimafia për zgjedhje të lira

"Koalicioni me LSI-në në momentin e duhur"

duke implikuar dhe prokurorinë, tashmë të kthyer në shërbim të plotë të kryeministrit, ata do të vihen përpara një surprize të madhe lidhur me atë çështje. Duhet vetëm të presim që Rama të çojë në fund lojën e tij.

Çfarë dosjesh tjera ka në dorë PD-ja që implikon ministrat e qeverisë "Rama" me krimin dhe korrupsionin dhe kur do të bëhen publike?

PD nuk krijon dhe nuk përgatit dosje në atë kup-tim që thoni ju. Ne nuk jemi as shërbim sekret e as institucion hetimi. Por sigurisht që ne denoncojmë çdo fakt që i vihet në dispozicion opozitës e që implikon qeverinë me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Në këtë këndvësh-tim, çdo fakt dhe dosje që do të jetë në duart tona, do të bëhet publike.

Cila do të jetë lëvizja e opozitës kundër kryeprokurores Arta Marku pasi ende nuk dihet sesa do të qëndrojë në krye të organit të akuzar si e emëruar...?

Sot kryeprokuror është Edi Rama, i cili veç të tjerave, pasi kapi prokurorinë, ka kaluar në kolaps edhe sistemin gjyqësor. Prandaj zgjidhja jo vetëm e kësaj çështje, por edhe i çdo problem që kanë sot

shqiptarët duke filluar nga naftëtarët e deri tek artistët, është vetëm një: largimi i Edi Ramës.

Si do të vijojë aksioni opozitar i opozitës nisur edhe nga fakti që tashmë janë pushimet e verës dhe kampionati botëror i futbollit gjë që mund të zbe-hë betejën e së djathtës kundër krimit të organi-zuar dhe lidhjeve të tij me politikën?

Sigurisht që edhe peri-udha e verës, por dhe kampionati botëror i futbollit duket sikur ndikojnë në zbehjen e luftës opozitare.

Ajo që është e sigurtë është se Edi Rama po përpjet e do përpjet ta shfrytëzojë këtë. Por as stina e verës e as qoftë dhe pikat e basteve që iu ka ofruar Rama, nuk do e ndryshojnë situatën e as nuk do e shpëtojnë dot atë. Sepse as vapa e as kampionati, nuk e ndryshojnë as reali-



KËRKESA

"Një qeveri antimafia duhet të luftojë krimin e organizuar të lidhur me politikën dhe të krijojë kushtet për zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme pas një reforme zgjedhore konsensuale në mënyrë që shqiptarët të vendosin me vullnet të lirë se nga kush duan të qeverisen",-deklaroj Edi Paloka.

tetin e shqiptarëve e nuk zgjidhin, as problemet e tyre. Ju e shihni që jo vetëm opozita, por dhe grupe të ndryshme interesi janë ngritur e protestojnë përditë ndaj kësaj qeverie për të cilën shqiptarët tashmë janë të bindur se është një qeveri që punon kundër interesave të tyre.

Çfarë kërkon PD aktualisht, zgjedhje të parakohshme apo përgatitjen e një terreni demokratik për votën e lirë?

Jo vetëm PD-ja, por i gjithë fronti opozitar e ka bërë të qartë qëndrimin e tij: Rama duhet të largohet. Një qeveri antimafia duhet të luftojë krimin e organi-zuar të lidhur me politikën dhe të krijojë kushtet për zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme pas një reforme zgjedhore konsensuale në mënyrë që shqiptarët të vendosin me

vullnet të lirë se nga kush duan të qeverisen. Vetëm kështu do të ringjallet shpresa dhe do t'i hapet rruga integritimit europian të vendit e vetmja pengese e të cilit është sot Rama dhe qeveria e tij.

Në zgjedhjet e ardhshme, qoftë normale apo të parakohshme, PD-ja do të jetë si koalicion me LSI-në?

Koalicionet do të vendosen në momentin e duhur. Ne sot jemi në një front opozitar me LSI-në dhe gjithë partitë e tjera me një qëndrim dhe një qëllim: largimin e Edi Ramës dhe kësaj qeverie antishqiptare, dhe krijimin e kushteve që shqiptarët të zgjedhin lirisht se nga kush duan të qeverisen.

Sipas jush cilat janë rrugët e PD-së drejt pushtetit?

Rruga e Partisë Demokra-tike drejt pushtetit është

AKUZA

Ne, tha z.Paloka, kemi votuar çdo ligj të kërkuar nga BE si kusht për integrimin, përfshi këtu dhe ndryshime kushtetuese që pa votën e PD nuk mund të kalonin. "Besoj ju e kujtoni cili ka qenë qëndrimi i Ramës në raste të ngjashme, kur BE kërkonte votimin e tri ligjeve që Rama nuk i votoi deri sa erdhi në pushtet",-deklaroj nënkryetari i PD-së.

vetëm një: zgjedhjet e lira dhe demokratike.

Çfarë e bashkon PD-në dhe çfarë e përcan atë momentalisht?

Ata që janë në PD i bashkon gjithçka e nuk i ndan asgjë. Kjo nuk do të thotë që ne nuk kemi mendime apo ide të ndryshme, që i debatojmë ato, por në fund qëllimet dhe interesat i kemi të përbashkëta. Kush nuk ka qëllime dhe interesa të përbashkëta me PD edhe pse mund të mbajë taserën e saj, nuk është pjesë e PD-së.

...Dhe si mund të marrin fund ndasitë brenda PD-së?

Siç ju thashë më lart, kur qëllimet dhe interesat e gjithsecilit janë të njëjta me ato të PD-së, atëherë pavarësisht ideve të ndryshme që mund të kemi për mënyrën se si duhen realizuar këto qëllime dhe interesa, ne jemi bashkë dhe ato që ju i quani ndasi, janë të parëndësishme. Kur interesat dhe qëllimet janë të ndryshme, atëherë nuk na bashkon gjë dhe nuk kemi pse bëjmë përpjekje për këtë.

Energjitë e Partisë Demokratike duhen përqendruar në luftën ndaj kundërshtarit dhe rikthimin e PD-së në pushtet, sepse ky nuk është vetëm interes i PD-së, por, mendoj, i shumicës së shqiptarëve sot.

“
Nënkryetari i PD-së u shpreh: "Koalicionet do të vendosen në momentin e duhur. Ne sot jemi në një front opozitar me LSI-në dhe gjithë partitë e tjera me një qëndrim dhe një qëllim: largimin e Ramës dhe kësaj qeverie antishqiptare, dhe krijimin e kushteve që shqiptarët të zgjedhin lirisht se nga kush duan të qeverisen".

të numëroj dhe shumë të tjera. Edhe largimi i Tahir-it erdhi si rezultat i këtyre betejave, sepse ju e dini që Rama e mbrojti dhe vazh-don ta mbrojë. Sigurisht opozita nuk është as prokurori e as gjykatë që të fusë Tahirin në burg, kjo është detyrë e organeve të drejtësisë, të cilat sot janë tërësisht në duart e Ramës. Edhe për rastin Xhafaj, është denoncimi dhe gjetja e fakteve nga opozita që e diskredituan dhe Fatmir Xhafajin, por dhe Ramën që është përgjegjësi për emërimin e dy ministrave të Brendshëm të lidhur direkt me klanet dhe familjet mafioze që kontrollojnë trafikun e drogës. Sigurisht Rama me të vëllanë, janë pjesë e tyre dhe tërësisht në shërbim të tyre. Çështja Xhafaj, ju garanton që nuk është mbyllur.

Që do të thotë...?
Kjo do të thotë që çështja Xhafaj, nuk është mbyllur.

Kreu i PD-së ka paralajmëruar një surprizë të madhe për qeverinë?

Për çfarë bëhet fjalë konkretisht?

Çfarë surprize do ishte nëse unë do ju a thosha juve sot... Zoti Basha e ka bërë të qartë vetë se pas lojës kriminale që po bëhet për të shpëtuar Xhafajin

VRASJA NE KURBIN DETAJET

Krimi i rëndë mes tregut, 35-vjeçarja Violeta Donaj tentoi të largohej pas vrasjes

"Oj nanë, ç'bëra unë", gruaja ekzekuton me 4 plumba bashkëshortin në Milot

Nëna e dy fëmijëve të mitur: Ishte xheloz, më dhunonte vazhdimisht

Ina Allkanjari

Krimi në familje ka goditur sërish. Mëngjesin e djeshëm Miloti është tronditur pasi një 35-vjeçare ka qëlluar me armë mbi bashkëshortin e saj, duke e lënë të vdekur në vend. Ngjarja ndodhi rreth orës 07:10, në tregun e Milotit në Kurbin. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se shtetasja Violeta Donaj, 35 vjeçe, banuese në Rrëshen, ka vrarë me pistoletë shtetasin Kujtim Donaj, 42 vjeç. Menjëherë pas vrasjes 35-vjeçarja e tronditur ka tentuar të largohet, por është vënë në prangat e policisë, teksa kishte dalë në autostradë dhe mbante duart lart. Sipas policisë shkak i konfliktit dyshohet se është bërë konsumimi i alkoolit dhe frekuentimi i lojërave të fatit nga Kujtim Donaj.

NGJARJA

Xhelozia, dhuna sistematike nga i shoqi, debatet për shkak të bixhozit dyshohet të kenë qenë shkaktarët e ngjarjes tragjike në Milot, ku Violeta Donaj, nënë e dy fëmijëve të mitur ka qëlluar katër herë me pistoletë ndaj bashkëshortit të saj, Kujtim Donaj. Dëshmitarët kanë dëgjuar fillimisht një debat mes gruas dhe 42 vjeçarit, dhe më pas janë dëgjuar të shtënë të pistoletës. Krimi i rëndë ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në mes të tregut të Milotit. Sipas dëshmitarëve çifti banonte në Rrëshen dhe çdo të diel shkonin në treg. Mësohet se Kujtim Donaj ka qenë duke hapur mallin në tezgën që kishte në treg, kur ka ardhur gruaja e tij dhe e ka qëlluar duke i shkakuar vdekjen e menjëhershme. Tregtarë në tregun e Milotit të frikësuar nga ngjarja thonë se nuk dinë asgjë rreth shkaqeve që çuan gruan 35 vjeçare në kryerjen e këtij akti ekstrem. Ata e njihnin çiftin Donaj si shtetësë rrabbe të fëmijëve në treg. Një nga tregtarët i tha



Autorja e vrasjes, Violeta Donaj



42-vjeçari Kujtim Donaj



Momenti i arrestimit të Violeta Donaj

policisë se viktima i kishte kërkuar gruas të bënte sa me shpejt 10 mijë lekë të vjetra xhiro dhe t'ia jepte atij. Gjithashtu, sipas dëshmitarëve mëngjesin kur ndodhi krimi, Kujtim Donaj kishte shkuar i pari në treg me një fugon mallrash. Pak minuta më vonë mbërriti Violeta Donaj, së bashku me kumatën. Sapo ka zbritur nga makina, 35 vjeçarja ka qëlluar ndaj bashkëshortit. Violeta ka qëlluar nga një distancë e afërt duke i sh-

kaktuar tre plagë në trup 42-vjeçarit, ndërsa një prej plumbave ka bërë rikoshet duke shkakuar panik edhe tek qytetarët që ndodheshin aty pranë. Pas kimit, 35-vjeçarja ka tentuar të largohet, por është ndjekur nga policia. Pak metra kilometra larg vendit të ngjarjes ajo është ndaluar nga një patrullë policie dhe nuk ka bërë rezistencë. Pas vrasjes 35-vjeçarja mes lotësh bërtet duke u penduar për krimin e rëndë. Ajo dëgjo-

VRASJA

Sipas dëshmitarëve mëngjesin kur ndodhi krimi, Kujtim Donaj kishte shkuar i pari në treg me një fugon mallrash. Pak minuta më vonë mbërriti Violeta Donaj, së bashku me kumatën. Sapo ka zbritur nga makina, 35 vjeçarja ka qëlluar ndaj bashkëshortit. Violeta ka qëlluar nga një distancë e afërt duke i shkakuar tri plagë në trup 42-vjeçarit, ndërsa një prej plumbave ka bërë rikoshet duke shkakuar panik edhe tek qytetarët që ndodheshin aty pranë.

SHKAKU

Në gjendje të rëndë psikologjike Violeta Donaj mësohet të ketë deklaruar gjatë shoqërimit në polici se shkak për aktin ekstrem ishte bërë dhuna sistematike nga i shoqi, e cila vinte si pasojë e xhelozisë që kishte ndaj saj Kujtimi.

het të thotë: "Oj nanë, ç'bëra unë". Në gjendje të rëndë psikologjike Violeta Donaj mësohet të ketë deklaruar gjatë shoqërimit në polici se shkak për aktin ekstrem ishte bërë dhuna sistematike nga i shoqi, e cila vinte si pasojë e xhelozisë që kishte ndaj saj Kujtimi. Po ashtu bazuar në deklaratat e gruas, bashkëshorti luante në lojëra fati, gjë që kishte ndikuar në krijimin e

vështirësive financiare. Ndërkohë grupi hetimor në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, po vazhdojnë hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
"PRODHIME KARBONIKE" SH.A.
(Carbon Plant Imp.&Exp. Co)

NJOFTIM

Adresa :
Zona Industriale Bradashesh
Elbasan EL 3000
Tel: +355 54 255 562
Tel/Fax: +355 583 226 244
E-mail: info@carbonplant.com
web: www.carbonplant.com
Kapitali 217.992.150 lekë
NIPIT J62903303 L / Kodi Fiskal 802528

Bazuar ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008, njoftojme mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise me kete rend dite:

1. Miratimi i pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2017 dhe i rezultatit financiar.
2. Miratimi i Programit te zhvillimit per vitin 2018.
3. Emerimi i ekspertit kontabel te regjistruar per auditim e pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2018.
4. Te tjera:
 - a) Rinovimi dhe miratimi i ODT.
 5. Miratimi i projekt rezolutave te ndryshme.

Mbledhja do te behet ne ambientet e selise se shoqerise me date **09 Korrik 2018, ora 11.30**

Dokumentat e nevojshme per mbledhjen e asamblese jane vene ne dispozicion ne seline e shoqerise.

Adresa jone eshte :
Prodhime Karbonike sha, (Zona Industriale),
Elbasan, Albania
Tel & Fax: +355 542 55 562
Fax : +355 583 26 244
E-mail: info@carbonplant.com

DREJTORI I PERGJITHSHEM
BASHKIM PROGRI



SHOQERIA PERMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :

1 - Truall me sip. 100 m². ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurise: 1/460, Vol.42, Fq.74, e ndodhur ne Tirane. Kjo pasuri eshte e hipotekuar ne favor te TIRANA BANK sha. Cmimi me te cilin fillon ankandi eshte 5.375.500 LEKE. Ankandi do te zhvillohet ne date 29.06.2018, ora 16.00 ne zyren e shoqerise "EPSA" shpk te ndodhur ne Rr "Ismail Qemali", Pall Fratar, K.6, Tirane.
2 - Truall + Ndertese, me sip. 552 dhe ndertese 206.5 m². ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurise: 6/43, Vol.20, Fq.17, e ndodhur ne Tirane. Kjo pasuri eshte e hipotekuar ne favor te TIRANA BANK sha. Cmimi me te cilin fillon ankandi eshte 952.000 EURO. Ankandi do te zhvillohet ne date 13.07.2018, ora 16.00 ne zyren e shoqerise "EPSA" shpk te ndodhur ne Rr "Ismail Qemali", Pall Fratar, K.6, Tirane.
Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj: Asnjë tolerim!

Masat antikorrupsion, ndjekje penale për 25 punonjës të Hipotekës dhe ALUIZNI-t



Masat antikorrupsion që kanë nisur të japin rezultatet e para konkrete. 25 punonjës të administratës publike, përkatesisht të ZRPP dhe ALUIZNI-t janë dërguar për ndjekje penale vetëm gjatë periudhës 16 prill-30 maj 2018, të akuzuar për veprën penale të korrupsionit. Gjatë takimeve të zhvilluara në njësitë administrative Oriukom dhe qendër në qarkun e Vlorës në kuadër të turit të llogaridhënies, "Puna për Shqipërinë që duam", ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj ka ndarë me banorët e këtyre zonave masat e marra dhe rezultatet e arritura në luftën kundër korrupsionit. "Që nga 16 prilli deri në 30 maj, pra në një periudhë 1

PROCEDIMI PENAL

"Që nga 16 prilli deri në 30 maj, pra në një periudhë 1 muaj e gjysmë janë dërguar për ndjekje penale 25 zyrtarë të Zyrvatë Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe ALUIZNI-t. Pra vetëm në 1 muaj e gjysmë janë marrë masa represive duke përfshirë që nga regjistruesit dhe deri te punonjësit më të thjeshtë", -ka deklaruar ministria Gjonaj.

muaj e gjysmë janë dërguar për ndjekje penale 25 zyrtarë të Zyrvatë Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe ALUIZNI-t. Pra, vetëm në 1 muaj e gjysmë janë marrë

masa represive duke përfshirë që nga regjistruesit dhe deri te punonjësit më të thjeshtë", ka deklaruar ministria Gjonaj. Në rolin e Koordinatorë Kombejtare antikorrupsion

Gjonaj është ndalur në veçanti në përbërjen dhe funksionim e Task Forcës antikorrupsion duke thënë: "Një ndër mekanizmat që është ngritur për të kapur dhe për të luftuar rastet e korrupsionit është pikërisht Task Forca kundër korrupsionit. Task Forca ka në përbërje të saj Drejtorinë e Antikorrupsionit pranë kryeministrit, Agjencinë e Prokurimeve Publike dhe një sërë drejtorish apo agjencish të tjera, të pavarura, të cilat të gjitha së bashku, në mënyrë ndërinstucionale do të bëjnë

të mundur që të gjitha zyrat e shtetit ku ofrohet shërbim të kapin rastet abuzive të kryera nga punonjësit e Administratës Publike". Ministria e Drejtësisë ju ka kërkuar banorëve që jo vetëm të mos pranojnë të japin rryshfet, port e denoncojnë çdo rast kur punonjësit e administratës u

kërkojnë shpërblim për shërbimet publike që ua garanton shteti pa pagesë. "Ju lutem, mos pranoi të jepni rryshfet dhe ju lutem, përsëri, zyrtarisht dhe personalisht: Denoncojini rastet e korrupsionit. Nuk tolerohet as edhe një", është shprehur ministria Gjonaj.

Autori i krimit, djali i komandantit të Policisë Kufitare në aeroportin e Tivatit

Në kërkim për vrasjen e të dashurës ukrainase, arrestohet në Tiranë malazezi

30-vjeçarja zotëronte një pasuri prej 105 milionë eurosh

Policia e Tiranës ka vënë në pranga ditën e djeshme një shtetas malazez të dyshuar për vrasje. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasin Arseni Stanoviç, i cili kishte hyrë ilegalisht në Shqipëri. Ai akuzohet se ka vrarë një shtetase nga Ukraina, Anastasije Lašmanove. Ndërkohë, pas arrestimit në Tiranë, i riu u depërtua për në Malin e Zi, ndërsa u mor në dorëzim nga shërbimet e policisë malazeze.

KRIMI

Në 11 maj të këtij viti, Arseni Stanoviç 22 vjeç, dyshohet të ketë vrarë të dashurën e tij ukrainase, Anastasia Lashmanova, duke e qëlluar disa herë me thikë në trup dhe duke i shtypur kokën. Mediat e huaja raportojnë se i riu ishte prej kohësh në një marrëdhënie me vajzën ukrainase, ndërsa policia kishte mbledhur shumë prova materiale që tregonin se pas krimit fshihej i riu, pasi thuhet se janë gjetur gjurmë që pasi iu bënë analizat rezultuan se përkohë me ADN e 22-vjeçarit. Mësohet se autori i krimit është djali i një komandantit të Policisë Kufitare në aeroportin e Tivarit, i cili u shkarkua dy ditë pas ngjarjes. 22-vjeçari ishte në një lidhje me vajzën ukrainase, 8 vite më të madhe dhe dyshohet se ka qëlluar me thikë dhe i ka shtypur kokën. Lashmanova u ther me thikë në apartamentin e saj, ndërsa ka qenë një mik i saj që ka njoftuar policinë.



Anastasije Lašmanove, viktima



Arseni Stanoviç, autori

HETIMI

Mediat e huaja raportojnë se i riu ishte prej kohësh në një marrëdhënie me vajzën ukrainase, ndërsa policia kishte mbledhur shumë prova materiale që tregonin se pas krimit fshihej i riu, pasi thuhet se janë gjetur gjurmë që pasi iu bënë analizat rezultuan se përkohë me ADN e 22-vjeçarit.

Ai kishte thënë se nuk arrinte të komunikonte me Anastasije Lašmanoven. Kishte shkuar dhe banesë, por askush nuk e hapte derën. Kur kanë mbërritur te banesa e saj, policia dhe zjarrfikësit kanë thyer derën e blinduar dhe janë përballur me një skenë të tmerrshme, gjak gjithandej. Kamerat e sigurisë së

ndërtesës si dhe lista e thirrjeve telefonike nga celulari i vajzës kanë bërë të mundur identifikimin e 22-vjeçarit Arseni Stanoviç. Hetuesit e çështjes kanë dyshime se ngjarja në fjalë është krim pasioni. Policia po heton ndër të tjera edhe për disa persona, përfshirë babanë e të dyshuarit, Zoran Stanoviç, i cili u shkarkua

dy ditë më parë nga pozicioni i komandantit të degës së Policisë Kufitare në aeroportin e Tivarit. Kjo pasi ai dyshohet se ka lejuar që i biri të kalonte kufirin drejt Shqipërisë.

VIKTIMA

Viktima, 30-vjeçarja Anastasije Lašmanove shkoi në Mal të Zi pak vite më parë dhe punoi si kameriere. Brenda një kohe të shkurtër u bë shumë e fuqishme dhe pasuritë që zotëronte, sipas vlerësimeve, vlejné dhjetëra miliona euro. Ajo ishte drejtoreshë e kompanisë "Sea Trade", pronare e hotel "Mimoza" në Tivar dhe kompleksit "Perla". Lashmanova është pronare e sallës së

bukurisë "Femme fatale" që gjendet në hotelin "Tre kane" në Budva. Ndonëse nga Ukraina, vajza erdhi në Malin e Zi me pasaportë ruse, ndërsa mediat malazeze vënë në pikëpyetje se si në pak vite e reja arriti të bëhej e pasur. Po ashtu, mediat flasin për një pasuri prej 105 milionë eurosh, duke u renditur si një nga

PASURIA

30-vjeçarja Anastasije Lašmanove shkoi në Mal të Zi pak vite më parë dhe punoi si kameriere. Brenda një kohe të shkurtër u bë shumë e fuqishme dhe pasuritë që zotëronte, sipas vlerësimeve, vlejné dhjetëra miliona euro. Ajo ishte drejtoreshë e kompanisë "Sea Trade", pronare e hotel "Mimoza" në Tivar dhe kompleksit "Perla". Lashmanova është pronare e sallës së bukurisë "Femme fatale" që gjendet në hotelin "Tre kane" në Budva.

personat më të pasur të Ukrainës. Ndërkohë, pas arrestimit në Tiranë, i riu u depërtua për në Malin e Zi, ndërsa u mor në dorëzim nga shërbimet e policisë malazeze.

Shitje me Ankand te Dyte nga Studio Permbartore L.D.C
 Trulli me sip. 1,874m2 nga e cila 250 m2 eshte ndertes, me Nr. Pasurie 134/33.vol. 25, faqe 82, ZK 2436 e ndodhur ne Levan, Fier, Regjistruar ne Z. R. P. P. Fier ne emer te Shoq. Albjon shpk. Çmimi fillestar per shitje eshte 6.180.854 Leka.
 Data e shpalljes 15.05.2018
 Data e zhvillimit 20.06.2018 deri ne oren 16.00
 Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

SIGURIMI I FERMERËVE PËRFITIMET

Voltiza Duro

Të gjithë ata fermerë që ushtrojnë aktivitetin e tyre bujqësor apo blegtoral në fshat, mund të kenë një sërë përfitimesh nëse sigurohen në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në njoftimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore bëhet me dije se nga ky sigurim fermerët mund të përfitojnë pension, vizita mjekësore pa pagesë si dhe kompensimin e çmimit të barnave në rast sëmundjesh. "Të nderuar fermerë! Sigurimi në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Ju që ushtroni aktivitet bujqësor dhe blegtoral, është investimi më i mirë që mund të bëni për veten dhe familjarët tuaj. Nga ky sigurim Ju përfitoni: Pension pleqërisë; Pension invaliditeti; Pension familjar për fëmijët tuaj; Sigurim për barërlindjen për nënat e reja; Vizitën mjekësore pa pagesë dhe kompensimin e çmimit të barnave mjekësore në rast sëmundjeje. Mos humbini kohë, mendoni për të ardhmen tuaj!", thekson ISSH në faqen e saj zyrtare.

KUSHTET E PËRFITIMIT

Bazuar në ligjin "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", personi që futet në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë disa kushte. Kështu individi duhet të ketë mbushur moshën 16 vjeç; të jetë i/e aftë për punë; dhe të mos jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë. Gjithashtu, i vetëpunësuar në bujqësi duhet të banojë në të njëjtin rreth ku ka tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim, dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore e blegtorale. Por ai edhe mund të banojë në fshat dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore dhe blegtorale, megjithëse tokën mund ta ketë në rrethin fqinjë. Vlen të theksohet se ka të drejtë të sigurohet çdo person deri në mbushjen e moshës për të dalë në pension.

PAGESAT E KONTRIBUTEVE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se sigurimi si i/e vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm dhe ky i/e vetëpunësuar/a, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh.

"Ndërkohë, i/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh.

Pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhen bashkërisht. Ato janë të detyrueshme dhe paguhen individualisht një herë në tre muaj", thekson ISSH. Sakaq, afati i fundit i këtyre pagesave është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për vitin në vazhdim, pavarësisht nëse janë të pasiguruar për vitet pararendëse. Pe-

"Kompensim të çmimit të barnave në rast sëmundjeje, dokumentacioni që nevojitet"

ISSH thirrje fermerëve: Sigurohuni, përfitoni pension dhe vizita falas

Kushtet për të aplikuar në skemën e sigurimeve



Foto ilustruese

MOSPAGIMI I KONTRIBUTEVE

ISSH thekson se të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë pasur kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t'i paguajnë kontributet për këto periudha sipas masës së kontributit.

PAGESAT

ISSH thekson se të vetëpunësuarit në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh", thekson ISSH.

SIGURIMI SHOQËROR

Kushtet për t'u siguruar

Personi që futet në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të ketë mbushur moshën 16 vjeç;
2. Të jetë i/e aftë për punë;
3. Çdo person mund të sigurohet deri në mbushjen e moshës për pension;
4. Nuk duhet të jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë;
5. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi duhet:

- Të banojë në të njëjtin rreth ku ka tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim, dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore e blegtorale;

- Të banojë në fshat dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore dhe blegtorale, megjithëse tokën mund ta ketë në rrethin fqinjë.

Pagesat e kontributeve

1. Sigurimi si i/e vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm.
2. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh.
3. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh.
4. Pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhen bashkërisht. Ato janë të detyrueshme dhe paguhen individualisht një herë në tre muaj.
5. Afati i fundit i këtyre pagesave është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT PËR T'U SIGURUAR

1. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi paraqet tek inspektori përkatës i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi këto dokumente:
 - Vërtetimin e pronësisë mbi tokën, dhe / ose Vërtetimin mbi tokën e marrë në përdorim, dhe / ose Kontratën e qiramarrjes së tokës bujqësore, të noterizuar;
2. Inspektori i të vetëpunësuarve në bujqësi, pasi gjykon për plotësimin e kushteve për sigurim si i/e vetëpunësuar në bujqësi plotëson dokumentin tip "Urdhër veprim" dhe ia jep fermerit;
3. Për të bërë pagesën paraqitet ky dokument në zyrën postare ose në zyrën bankare. Me kryerjen e pagesës zyra postare lëshon dokumentin "Mandat arkëtimi", ndërsa me kryerjen e pagesës në zyrën bankare lëshohet dokumenti "Veprim arke", i cili konfirmon kryerjen e kësaj pagesë;
4. Me dokumentin "Mandat arkëtimi" ose "Veprim arke" fermeri paraqitet për regjistrim tek inspektori i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, ku ka marrë "Urdhër veprimin";
5. Këto dokumente në asnjë rast nuk duhet t'i dorëzohen punonjëseve të sigurimeve shoqërore. Ato janë personale;
6. Në fund të procedurës dhe pas pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore bëhet pajisja e detyrueshme me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
7. Me kërkesën e të vetëpunësuarit në bujqësi ai pajiset nga organet e sigurimeve shoqërore edhe me vërtetimin tip "Për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore"

riudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen si periudha sigurimi. Ndërkohë të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kushtin minimal të vjetërsisë në punë, për të përfituar pension të pjesshëm, mund të kryejnë pagesa kontributesh pas plotësimit të moshës për pension, por me kusht që ato t'u korrespondojnë periudhave para plotësimit të moshës për pension dhe të mos jetë caktuar ende asnjë lloj pensioni dhe për këto periudha do të paguhet sipas masës së kontributit. ISSH thekson se të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë pasur kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t'i paguajnë kontributet për këto periudha sipas masës së kontributit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin kur kryhet pagesa.

PËRFITIMET NGA SKEMA

Personat e vetëpunësuar

në bujqësi që përshihen në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore mund të përfitojnë nga kuotat e ulta të pagesave të kontributeve. "Për një vit vjetërsie në punë në shtet një i/e vetëpunësuar në qytet paguan 66 240 lekë, ndërsa: a) I/e vetëpunësuar/a në zonat fushore paguan 38 400 lekë në vit; b) I/e vetëpunësuar/a në zonat malore paguan vetëm 29 400 lekë në vit", nënvizon ISSH. Por fermerët e vetësiguruar marrin edhe përfitim të vjetërsisë në punë, ku njihja e periudhave për të cilat janë paguar kontribute njihet vjetërsi në marrëdhënie pune me shtetin. "I/e vetëpunësuar/a në bujqësi, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, është përfitues/e, sipas rastit, i/e Pensionit bazë të pleqërisë; Pensionit të pjesshëm të invaliditetit; Pensionit familjar; Shpërblimin për lindje fëmijë", bën me dije Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marërdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës për gatit informacionin e kërkuar dhe njohon subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikim për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.



KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkesues)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkesues)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
294	Devoll	Koço		Maxhe	520 m2 240 m2	
698	Devoll	Selami		Pysqyli	2244 m2	Neni 21 e drejte paraberje e objektit
700	Devoll	Hyrije		Kulla	1100m2 400m2 3000 m2	Neni 21 e drejte paraberje e objektit
704	Devoll	Edi		Kapshtica	1437 m2	Neni 21 e drejte paraberje e objektit. Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit
691	Devoll	Kostaq		Necka	240 m2 120 m2	Neni 21 e drejte paraberje e objektit
692	Devoll	Hamdije		Hyska	5682 m2 900 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
		Hamdije		Hyska	6000m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
693	Devoll	Sefedin		Lumi	5000 m2	Neni 21 e drejte paraberje e objektit. Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit
694	Devoll	Pakise		Kurti	1000 m2	Neni 21 e drejte paraberje e objektit. Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit
695	Devoll	Harif		Karaxhuku	1000 m2	
696	Devoll	Komisioni I Fese Myslimane		Komisioni I Fese Myslimane	600 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
697	Devoll	Adil		Mullaj	2040 m2 2485 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
699	Devoll	Fitret		Zaci	750 m2	
701	Devoll	Makbule		Gjiriti	500 m2 1000 m2 800 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
702	Devoll	Nafije		Spaho	600 m2 2000m2	
703	Devoll	Eleni		Strati	75 m2	
705	Devoll	Idajete		Bejleri	1000m2 3570 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
707	Devoll	Tatjana		Dushku	2000 m2	Neni 12 t1 paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit
708	Devoll	Saime		Pleshti	3000m2	
709	Devoll	Halim		Starja	2845 m2	
710	Devoll	Mustafa		Shamo	2000 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
908	Devoll	Gjergji		Kovaci	245 m2	
910	Devoll	Dashamir		Qeraxhi	3350 m2	
706	Devoll	Hysen		Shehu	1000 m2	
637	Devoll	Agim		Shkembi	920 m2	
906	Devoll	Dimitër		Pirritli	192 m2	
888	Devoll	Sotriq		Pine	8000 m2	
899	Devoll	Haki		Hoxha	98 25 m2	
896	Devoll	Servet		Bode	1170 m2	
81	Devoll	Skender		Dervishi	Refuzim kerkese	
227	Devoll	Xheviko		Vrioni (Kollunaku)	750 m2	
895	Devoll	Hydaj		Rapi	Refuzim kerkese	
905	Devoll	Dylber		Karaxhuku	800 m2	
995	Devoll	Zyfer		Zyfi	1440 m2	
754	Devoll	Riza		Olli	Refuzim kerkese	
809	Devoll	Ylli		Xhafi	Refuzim kerkese	
811	Devoll	Sefedin		Xhuti	Refuzim kerkese	
603	Devoll	Kristaq		Shkodrani	173 m2	
159	Devoll	Bardhyl		Olli	Refuzim kerkese	
893	Devoll	Ilirjan		Muci	Refuzim kerkese	
833	Devoll	Thoma		Teli	1238 m2	
904	Devoll	Hava		Shkembi	2540 m2	
680	Devoll	Glinim		Hoxha	1500 m2	
894	Devoll	Gezim		Dule	396 m2	E drejte paraberje e angarit 60 m2

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkesues)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkesues)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
677	Devoll	Xheviko		Dule	Refuzim kerkese	
649	Devoll	Syrja		Kape	Refuzim kerkese	
744	Devoll	Ziqiri		Bode	Refuzim kerkese	
883	Devoll	Trifon		Bejleri	Refuzim kerkese	
650	Devoll	Mine		Hoxha	1000 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
					1000 m2 500 m2 914 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit
647	Devoll	Fitret		Hoxha	500 m2 6900 m2	
648	Devoll	Teki		Hyska	Refuzim kerkese	
646	Devoll	Seit		Zorba	250 m2	
645	Devoll	Kama		Myrte	2000 m2	
						Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. Neni 21 e drejte e paraberjes.
638	Devoll	Efigjeni		Temo	220 m2	
641	Devoll	Xheviko		Hysi	1000 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
643	Devoll	Ismete		Spaho	1240 m2 250 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
642	Devoll	Ifak		Pellumbi	700 m2	
640	Devoll	Trash.		Kambolli	600 m2 2700 m2	
639	Devoll	Hajrije		Hysi	1200 m2	
636	Devoll	Fejzi		Ulenga	70 m2 24 m2 300 m2 120 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
635	Devoll	Melike		Spaho	300 m2 1000 m2	
634	Devoll	Uri		Zami	390 m2 850 m2	
633	Devoll	Xhewat		Tarelli	150 m2 224 m2	
632	Devoll	Selami		Tarelli	350 m2 1200 m2	
631	Devoll	Ahmet		Xhamia	300 m2 682 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
257	Devoll	Enverie		Ajce	Refuzim kerkese	
		Enverie		Ajce	3062 m2 1768 m2 620 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
252	Devoll	Safet		Gjiriti		
		Safet		Gjiriti	700 m2 300 m2 2000 m2 2000 m2 1300 m2	
256	Devoll	Kosta	Xhimi	Peti	70 m2 168 m2 132 m2	
253	Devoll	Fetije		Qoshe	7129 m2	
251	Devoll	Leonidha		Pine	Refuzim kerkese	
254	Devoll	Resmije		Hajderlliu	4500 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
255	Devoll	Qamil		Hysi	480 m2 1600 m2	
258	Devoll	Safet		Seit	500 m2	
259	Devoll	Ajko		Pysqyli	1924 m2	Neni 12 t1 paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
260	Devoll	Kirret	Xhemali	Lulo	360 m2 1363 m2 808 m2	
261	Devoll	Kosta		Cili	Refuzim kerkese	
262	Devoll	Halit		Lico	910 m2 147 m2	
316	Devoll	Merzan		Harderlliu	394 m2 300 m2 2268 m2 shtepi	
317	Devoll	Muharrem		Braka	139 m2 900 m2	
309	Devoll	Lumturi		Agasta	1050 m2	
		Lumturi		Agasta	2800 m2	
318	Devoll	Skender		Shaholli	579 m2	
314	Devoll	Dervish		Hamit	250 m2 380 m2 250 m2	
319	Devoll	Mevlude		Lico	Refuzim kerkese	
				Lico	650 m2	
				Lico	2660 m2 2125 m2	
320	Devoll	Bekdash		Hoxha	Refuzim kerkese	
306/1	Devoll	Dhioqjen		Spirollari	528 m2	

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kerkues)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kerkues)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
307	Devoli	Nuriman		Jazxhi	475 m2 4500 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
308	Devoli	Nevruze		Bajraktari		
310	Devoli	Shege		Myto		
311	Devoli	Arife		Kanina		Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. Neni 21 e drejta e parablejtes.
		Arife		Kanina	Per sip. 400 m2 te kerkoje lirimin e truallit.	
312	Devoli	Faiko		Zaimi	700 m2 120 m2	
313	Devoli	Mynevere		Bajraktari	520 m2 600 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit. Neni 21 e drejta e parablejtes.
315	Devoli	Riza		Zenuni	Truall 59/1 59/2 59/5 59/6	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
623	Devoli	Sanije		Spaho	330 m2 960 m2 90 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
625	Devoli	Demir Rexhep Jashar Xhaferr		Kutrolli	Refuzim kerkese	
624	Devoli	Qasibe		Bylykbashi	1000 m2 2500 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
626	Devoli	Neki		Bylyku	250 m2 1400 m2 1600 m2	Neni 21 e drejte parablejtes
625	Devoli	Vasfie		Allaj	Refuzim kerkese	
628	Devoli	Lyftie		Mucka	700 m2	
		Lyftie		Mucka	700 m2	
627	Devoli	Shemsi Muhamet Myzejen Suzana		Çakshiri	Refuzim kerkese	
622	Devoli	Barije		Barolli	1000 m2	
621	Devoli	Senvet		Zhuleku	3784 m2	
620	Devoli	Arif		Groballi	374 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
619	Devoli	Hajrije		Goca	800 m2	
618	Devoli	Riza		Qamil	100 m2	
617	Devoli	Haxhi		Merolli	550 m2 250 m2 285 m2	
616	Devoli	Razije		Jahja	270 m2	
615	Devoli	Sali		Shkembli	400 m2 250 m2	
614	Devoli	Antoneta		Qind	192 m2	
613	Devoli	Safet		Ago	500 m2 1435 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
612	Devoli	Selajdin		Berberi	Refuzim kerkese	
611	Devoli	Hamdiqe		Kaso	323 m2 452 m2 550 m2	
630	Devoli	Mustafa		Muci	384 m2 336 m2 774 m2	
52	Devoli	Hajrie		Zerani		
		Hajrie		Zerani		
		Hajrie		Zerani	1000 m2 150 m2 3500 m2	Neni 21 e drejte parablejtes
50	Devoli	Bujar		Lilka	300 m2 1500 m2 2000 m2	
48	Devoli	Irfan		Qose		
53	Devoli	Fetije		Ocka		Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
47	Devoli	Rasim		Sherolli		Neni 21 e drejte parablejtes.
		Rasim		Sherolli		Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
49	Devoli	Nafie		Kambo	300 m2	
51	Devoli	Fejzi		Haxhi		
54	Devoli	Hediat		Ganolli	84 m2 210 m2 227 m2 2050 m2 300 m2	
					Anullim i Vendimit Nr. 32 19.01.1994	
					1345 m2 300 m2	Neni 21 e drejte parablejtes. Neni 12 t'i paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
55	Devoli	Ajrije		Agolli		
56	Devoli	Koço		Kaliço		Vendimi nuk lexohet.
57	Devoli	Nihat		Tarelli		
60	Devoli	Fatime		Myto	500 m2 300 m2 725 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
59	Devoli	Sybi		Agastr	500 m2 300 m2 725 m2	
58	Devoli	Petro		Stojko	825 m2 188 m2	
61	Devoli	Muhamet		Mekaj	250 m2 shtepi	
		Muhamet		Mekaj	250 m2 shtepi	
46	Devoli	Qerime		Spaho	533 m2	Neni 21 e drejte parablejtes
44	Devoli	Polixsen		Melonashi		
31	Devoli	Faik		Meco		
33	Devoli	Avni		Musa		
		Avni		Musa		
		Avni		Musa		
34	Devoli	Shaban		Azo	T'i ktheje dokumentat subjektit.	
		Shaban		Azo	162 m2	
36	Devoli	Aslan		Mane	3000 m2	
38	Devoli	Aqif		Musa		
		Aqif		Musa		
43	Devoli	Kozma		Eski		
37	Devoli	Myrteza	Sali	Çeta		
35	Devoli	Ervehe		Spaho		Neni 21 e drejte parablejtes
40	Devoli	Hava		Çela	600 m2 250 m2 2350 m2	
41	Devoli	Raif		Vullinetari	3800 m2	E drejte e bashkpreponise.
		Raif		Vullinetari	3800 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
39	Devoli	Sulejman		Merolli		
45	Devoli	Aishe		Sherolli		
		Aishe		Sherolli	1000 m2	
42	Devoli	Sezai		Voco		
32	Devoli	Adriatik		Topgju	Refuzim kerkese	
236	Devoli	Gani		Muka	660 m2 120 m2	
237	Devoli	Mahmudi		Merolli	600 m2	
239	Devoli	Sabri		Haxhi	400 m2 200 m2	
238	Devoli	Hamide		Lirioni	500 m2	
240	Devoli	Ibrahim		Lumi	8000 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
241	Devoli	Xhafide		Shaholli	150 m2 520 m2 1800 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
242	Devoli	Enverije		Hoxha	1000 m2 500 m2	
243	Devoli	Muhamet	Demirali	Meka	1131 m2	
245	Devoli	Vasile		Priifti	168 m2	
244	Devoli	Efigjeni		Eski	55 m2 302 m2 101 m2 90 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
246	Devoli	Myfit		Tarelli	350 m2	
249	Devoli	ikbale		Mankolli	150 m2 1200 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
248	Devoli	Vaske		Priiftuli	48 m2 20 m2	
250	Devoli	Xhevati		Mulla	200 m2 300 m2	
666	Devoli	Sali		Kondi	1000 m2 2000 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
660	Devoli	Violeta		Hatija	Refuzim kerkese	
		Violeta		Hatija	1000 m2	
665	Devoli	Horma		Terpini	383 m2 1080 m2	Neni 21 e drejte parablejtes
					496 m2 240 m2	

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kerkues)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kerkues)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
661	Devoli	Fatime		Rushitaj	462 m2	
662	Devoli	Fadil		Zerani	200 m2 3500 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
663	Devoli	Fazili		Zerani	300 m2 592 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
664	Devoli	Reshat Nadire		Sino	900 m2 100 m2 600 m2	Neni 21 e drejte parablejtes. Neni 12 t'i paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
667	Devoli	Shpresa Pasholli Sherradije		Pasholli	2500 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
669	Devoli	Bujar		Bejleri	480 m2 2000 m2 2160 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
658	Devoli	Petrika		Gjylameti	150 m2	
668	Devoli	Avni		Hoxha	1000 m2 2000 m2	Neni 12 t'i paguaj qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
653	Devoli	Hasan		Shehu	1100 m2 400 m2 3000 m2	
652	Devoli	Rudnije		Agolli	4000 m2 150 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
670	Devoli	Enver		Kollovozi	1000 m2	Neni 12 t'i paguajne qera ose t'ia riblejne truallin pronarit.
659/1	Devoli	Qanije		Spaho	261 m2 665 m2	
659	Devoli	Lirije		Musa	Refik Xhelil Njazi nga 1/3 pjese 450 m2 5974 m2	
656	Devoli	Fatmir		Bablusha	645 m2	
					645 m2	
655	Devoli	Kodi		Hametli	945 m2	
654	Devoli	Bukurije		Kusi	1479 m2	
426	Kolonje	Viktor		Tasho	1620 m2	
398	Kolonje	Elena		Aliçka	1074 m2	
442	Kolonje	Shaban		Male	7740 m2	
88	Kolonje	Nevruz		Maluka	1127 m2	
		Nevruz		Maluka	1571 m2	
		Nevruz		Maluka	Refuzim kerkese.	Kjo prone i eshte njohur z. Jorgji e Mikail Prodat.
		Nevruz		Maluka	3518 m2 13 657 m2 1811 m2	Neni 20 bashkpreponise. Neni 21 e drejte parablejtes.
279	Kolonje	Bektash		Male	1107 m2	
455	Kolonje	Selman		Koçillari	3314 m2	Neni 21 e drejte parablejtes e objektit.
433	Kolonje	Tomor		Ypi	2000 m2 1000 m2	
436	Kolonje	Ervehe		Male	1221 m2	
438	Kolonje	Sotir		Muco	1046 m2	
445	Kolonje	Marijanti		Kozmallari	798 m2	
446	Kolonje	Muhamet Isa		Sako	737 m2 2829 m2	
420	Kolonje	Ferit		Kozeli	8302 m2 shtepi 1 kt 70 m2	
416	Kolonje	Dajlan		Jupe	1694 m2	
409	Kolonje	Taki		Kapolli	10 241 m2 2039 m2	
7879	Kolonje	Serafin		Kuke	226.7 m2	
					16 935 m2	
82	Kolonje	Refize		Shupe	6189 m2	
181	Kolonje	Myslim		Maksuti	460 m2 350 m2	
361	Kolonje	Gezim		Pepi	2000 m2	
402	Kolonje	Llambi	Kosta	Kole	1269 m2	
410	Kolonje	Gani		Feka	7233 m2 280 m2	Neni 21 e drejte parablejtes e objektit.
440	Kolonje	Neim		Rusi	6000 m2 750 m2	Neni 21 e drejte parablejtes e objektit.
444	Kolonje	Vasil		Mijt	797 m2 1040 m2	
412	Kolonje	Ruzhdi		Skenderi (Frasheri)	1145 m2	
373	Kolonje	Orhan		Bacellari	3746 m2	
458	Kolonje	Shendet		Mbreshani	3164 m2	
446	Kolonje	Ekurani		Muci	3340 m2	
427	Kolonje	Savro		Zizi	91 m2	
430	Kolonje	Pellumb		Ismaili	2302 m2	
437	Kolonje	Rabhan		Dilo	4437 m2	
439	Kolonje	Kasem		Shkurti	2127 m2	
411	Kolonje	Petref		Babaxhani	3050 m2	
65	Kolonje	Isuf		Baqj	15 512 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
358	Kolonje	Hekuran		Kore	1050 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
137	Kolonje	Ylli		Ilijazi	1581 m2 63 m2 96 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
243	Kolonje	Varvara		Shkurti	90 m2 154 m2 224 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
8	Kolonje	Polixseni		Lolo	456 m2	Neni 20 bashkpreponise per sip. 450 m2. Vendimi dhe planvendosja pa vule.
252	Kolonje	Naima		Lilo	3210 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
253	Kolonje	Haki		Lilo	1760 m2	Neni 21 e drejte e parablejtes se objektit. Vendimi dhe planvendosja pa vule.
337	Kolonje	Memedi		Tare	2116 m2 3128 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
338	Kolonje	Murat		Hasani	4606 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
327	Kolonje	Selvi		Sula	625 m2 300 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
168	Kolonje	Koli	Jongaç	Priifti	490 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
379	Kolonje	Vasil		Gaci	1100 m2 240 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
389	Kolonje	Sherife	Guri	Meko	3275 m2 1121 m2 1244 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
285	Kolonje	Lefter		Birinaku	1099 m2 468 m2	Neni 21 e drejte e parablejtes se objektit. Vendimi dhe planvendosja pa vule.
123	Kolonje	Veip		Lumani	128 m2 405 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
21	Kolonje	Orita		Xhillanga	shtepi 2 kt 853 m2	Neni 21 e drejte e parablejtes se objektit. Vendimi dhe planvendosja pa vule.
248	Kolonje	Refiko		Veizi	1314 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
154	Kolonje	Sultana		Jaupi	3104 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
250	Kolonje	Muharem		Doko	360 m2 4385 m2 1872 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
146	Kolonje	Sefedin		Mydini	7050 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
301	Kolonje	Hasan		Hasani	2850 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
302	Kolonje	Vaslika		Petro	1403 m2	Vendimi dhe planvendosja pa vule.
19	Kolonje	Barthe		Kardhiqi	2386 m2	
16	Kolonje	Liri		Boçi	Refuzim kerkese	
33	Kolonje	Vangiel		Kita	247 m2 152 m2 156 m2 158 m2 100 m2 880 m2 817.5 m2 420 m2	Neni 21 e drejte e parablejtes se objektit.
39	Kolonje	Illa		Mici	52 m2	

KORÇË

Table with columns: Nr./Drojes, Rrethi, Emri (Subjekti kerkues), Atesia 2, Mbledhmi (Subjekti kerkues), Sip. E Njohjur/ Mosnjohje M2, Problematika. Contains entries for various districts like Thoma, Drita Mersini, etc.

Table with columns: Nr./Drojes, Rrethi, Emri (Subjekti kerkues), Atesia 2, Mbledhmi (Subjekti kerkues), Sip. E Njohjur/ Mosnjohje M2, Problematika. Contains entries for various districts like Demir, Shefqet, Nazarko, etc.

(vijon)

Miratohet emri "Maqedonia e Veriut", nis rruga e bashkëpunimit në Ballkan

Historike/ Nënshkruhet marrëveshja Maqedoni-Greqi

Akordi Maqedoni-Greqi, ja kush ishte prezent

Më në fund, pas 27 viteve ngërçi gjeo politik, mbyllet një kapitull me shumë negociata. Arrihet marrëveshja historike mes Greqisë dhe Maqedonisë për emrin e saj të ri, ndërsa ajo do të quhet "Maqedonia e Veriut". Dëshmitarë të kësaj ngjarje të rëndësishme u bënë ndërmjetësuat i OKB-së për çështjen e emrit, Methju Nimiç, përfaqësuesja e Lartë e BE, Federika Mogherini, Eurokomisioneri për Zgjerim, Johannes Han dhe Rozmari Di Karlo, si dhe zëvendësja e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Antonio Gutierrez. Marrëveshja u nënshkrua në Nivici të Greqisë, mes Nikolla Dimitrov dhe ministrit të Jashtëm grek, Nikos Koxias. Pas ceremonisë së nënshkrimit, liderët e dy vendeve dhe delegacionet ndërkombëtare do të qëndrojnë edhe në anën maqedonase të Prespës. Marrëveshja e arritur mes Maqedonisë dhe Greqisë, për ndryshimin e emrit në "Republika e Maqedonisë së Veriut", paraqet një bazament shumë të shëndoshë për t'i dhënë fund kontestit dy dekadash, mes dy vendeve fqinje, thonë njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare duke shtuar se kjo marrëveshje përpos që hap perspektiva për të ardhmen e shtetit me rëndësi të veçantë është se nuk preket identiteti i maqedonasve. Lëshimi që ka bërë pala maqedonase rreth kërkesës greke për të ndryshuar Kushtetutën e shtetit, ekspertët e shohin si zgjidhje më optimale që mund të arrihej, sepse ky lëshim i mundëson Maqedonisë të integrohet në NATO dhe BE. Ministri i parë i Punëve të Jashtme i Maqedonisë, Denko Malevski, pas pavarësimit të shtetit, në një intervistë për Radion "Europa e Lirë", thotë se pasi ka shqyrtuar me kujdes marrëveshjen në fjalë, konstaton se çështja e identitetit të maqedonasve mbetet e garantuar. Malevski thotë se si dip-



lomat ka mësuar një çështje të rëndësishme, atë se shteti duhet shfrytëzuar valët e interesit duke notuar me sukses në to. "Duhet të shfrytëzohet maqedonasi dhe përfundimisht si shtet të bëhemi pjesë e institucioneve ndërkombëtare, pjesë familjes europiane, botës moderne". "Mendoj se me këtë marrëveshje përpos që i hapet rrugë integritit të vendit në strukturat euroatlantike hapet dhe një faqe e re e miqësisë dhe bashkëpunimit këtu në Ballkan, që është me një

rëndësi të veçantë për perspektivën e të gjitha vendeve të rajonit", thotë Denko Malevski. Malevski, duke komentuar qëndrimin e Presidentit të Maqedonisë, Gjorgje Ivanov që të mos e ratifikojë marrëveshjen, thotë se këtë vendim të tij e kupton "si refuzim që të anulohet një politikë e gabuar e qeverisë së kaluar e drejtuar nga VMRO DPMNE nga ku vjen dhe vetë presidenti, politikë kjo e cila është promovuar dekadën e fundit mes dy vendeve fqinje dhe jo si vendim në funksion të mbrojtjes së interesave shtetërorë". Ekspertët shqiptarë

thonë se me rëndësi të veçantë për shqiptarët është se me këtë marrëveshje përpos që vendit i hapen më shumë perspektiva në planin e integritimit, me riemërtimin e shtetit si "Maqedonia e Veriut" bëhet një ndarje e qartë e shtetit nga kombësia maqedonase. Arsimit Sinani nga Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike, për radion "Europa e Lirë" thotë se kërkesa e krahut të Bashkuarëve për riemërtimin e institucioneve ose heqjen e prefiksit maqedonas duke definuar ekskluzivitetin e përkatësisë vetëm për maqedon-

asit, tani bëhet realitet jo si rrjedhojë e vullnetit të autoriteteve maqedonase, por si rrjedhojë e insistimit të palës greke që ata të riemërtohen, siç theksohet qartë në marrëveshje. "Mendoj se më tepër është insistimi i palës greke që "erga omnes" të vlejë për të gjitha çështjet, përfshi këtu dhe riemërtimin e institucioneve të shtetit dhe atyre publike. Mendoj se faktori politik shqiptar është në përbërjen e sipërme në mesin e tyre nuk mendoj se ka njerëz të mençur që kanë vizion për të realizuar kërkesat e shqiptarëve"-thotë Sinani. Ndërkohë që qeveria e Maqedonisë në ueb, faqen e saj zyrtare, të enjten në mbërmje e ka publikuar marrëveshjen e përbërë prej preambulës, 3 pjesë dhe dispozita ekzekutive, me gjithsej 20 nene, e bart titullin "Marrëveshja Përfundimtare për Zgjidhjen e Dallimeve të Përkshkrura në Rezolutën 817 (1993) dhe 845 (1993) në Këshillin për Siguri të Kombeve të Bashkuara, për Ndalimin e Vlefshmërisë së Marrëveshjes së Përkohshme nga Viti 1995 si dhe Vendosjen e Partneritetit Strategjik mes Palëve". Pas arritjes së marrëveshjes Maqedoni-Greqi, gjatë javës që po e lëmë pas autoritetet e qeverisë së Maqedonisë kanë theksuar se shpresojnë që në fund të qershorit Maqedonia të marrë rekomandim pozitiv nga Brukseli për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e vendit në BE.

SHKURT

Gruaja sulmon me thikë punonjësit në një

supermarket në Francë

Allahu Ekber", kjo ka qenë shprehja që një grua ka thënë teksa ka plagosur dy persona në një supermarket në La Seyne-sur-Mer në Francë. Ngjarja ka ndodhur mëngjesin e së dielës rreth orës 10:30. Sipas dëshmitarëve, skena fillimisht dukej si një grindje mes punonjësve të supermarketit dhe saj. Më pas ajo u ka ngulur thikën. Kanë qenë të pranishmit ata që kanë larguar gruan dhe më pas është arrestuar nga policia, njofton "Le parisien".

Marsh i barazisë në Kiev të

Ukrainës

Mbrojtësit e të drejtave të komunitetit LGBTQ+ po mbledhen në qendër të Ukrainës në Kiev për të organizuar marshin e krenarisë, në mes të forcave të shumta të sigurisë. Organizatorët presin rreth 5,000 pjesëmarrës në marshin që do të zgjasë rreth një orë. Rugët u mbyllën për veturat në qendër të qytetit, ndërsa janë angazhuar rreth 5000 forca policore për të mbajtur rendin. Organizatorët, të cilët kanë pranuar kërcënime nga grupe të krahut të djathtë, kështu për pjesëmarrësit të mos mbajnë banerë apo mbishkrime të këtij komuniteti, pa arritur në vendin ku mbahet ngjarja.

Trump ndan fëmijë nga prindërit

Rreth 2000 fëmijë emigrantë janë ndarë nga familjarët e tyre gjatë javëve të fundit, në kufirin mes SHBA-së dhe Meksikës. Kjo ka ardhur pas një urdhri që dha administrata e Trump për të ndaluar të gjithë ata që kalojnë apo kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Çështja e emigrantëve në SHBA tani po shkakton një stuhitë politike. Ky veprim ka ndodhur nga data 19 prill deri më 31 maj, pas hyrjes në fuqi të politikës me "tolerancë zero" të administratës Trump, kundër emigracionit klandestin. Të gjithë emigrantët që kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, tashmë ndiqen penalisht, arrestohen dhe dërgohen në paraburgim. Ndryshe nga legjislacioni i mëparshëm, që kalimin e kufirit e parashikonte si veprë që dënohej vetëm me gjobë. Krahas ndalimit të të rriturve që paraburgosen, për të miturit që konsiderohen të pasqorë, prindërit humbasin kujdestarinë. Kjo ka bërë që të shpërthejnë polemikat për të shkëlqen e të drejtave të fëmijëve, denoncuar edhe nga OKB.

Sejdiu: Ky është një konflikt interesi sipas AKK

Rritja e pagave në Kosovë, Vetëvendosja paralajmëron kallëzim penal ndaj qeverisë

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është skandaloz po aq sa ishte vendimi i qeverisë Haradinaj për rritjen e pagave". Këto janë deklaratat e Lëvizjes Vetëvendosje në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për rritjen e pagave për zyrtarët e qeverisë. Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci thotë se me votimin pro kanë shkelur nenin 424 të kodit penal, i cili paraqet konflikt interesi. E për këtë, Nagavci thotë se do të bëjnë kallëzim penal ndaj qever-

KORAB SEJDIU:

"Në aspekt kushtetues është dhënë ky vlerësim mirëpo qëndron edhe aspekti ligjor ku e kemi një mendim të AKK-së, i cili e ka cilësuar këtë vendim si konflikt interesi dhe zbatimi i këtij vendimi nga ana e qeverisë natyrisht do të implikonte veprime të mëtejshme nga ana e Agjencisë, potencialisht për të bërë edhe kallëzim penal ndaj atyre që edhe kanë votuar edhe e zbatojnë", thotë Sejdiu.

isë në tërësi, duke përfshirë edhe ministrat që e kanë votuar një ligj të tillë. "Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është skandaloz sa vetë vendimi i qeverisë Haradinaj. Përveç shkeljeve kushtetuese duke qenë se me marrjen e këtij mendimi

Kryeministri Haradinaj dhe të gjithë ministrat që kanë votuar pro kanë shkelur nenin 424 të Kodit Penal duke votuar për një çështje që paraqet konflikt interesi, atëherë ne do ta procedojmë këtë duke bërë një kallëzim penal për kryeministrin Ha-



radinaj dhe të gjithë ministrat që kanë votuar pro", -tha Nagavci për Tribuna Channel. Deputeti i pavarur, Korab Sejdiu thotë se mendimi mospajtes i dy gjyqtarëve në Kushtetuese, është më i arsyeshëm dhe më i qartë se sa aktgjykimi i shumicës. Por Sejdiu thotë se mendimi ndryshe i Agjencisë Anti Korrupsion potencialisht mund të bëjë edhe kallëzim

penal. "Në aspekt kushtetues është dhënë ky vlerësim mirëpo qëndron edhe aspekti ligjor ku e kemi një mendim të AKK-së, i cili e ka cilësuar këtë vendim si konflikt interesi dhe zbatimi i këtij vendimi nga ana e qeverisë natyrisht do të implikonte veprime të mëtejshme nga ana e Agjencisë, potencialisht për të bërë edhe kallëzim penal ndaj atyre që edhe kanë votuar edhe e zbatojnë", thotë Sejdiu. Në anën tjetër, këshilltari i kryeministrin Ramush Haradinaj, Halil Matoshi, thotë se është e drejtë e opozitës që të bëjnë kallëzim penal në lidhje me vendimin për rritje të pagave. Gjykata Kushtetuese konstatoi se nuk ka shkelje me vendimin e qeverisë për rritje të pagave për kabinetin qeveritar, ku paga e kryeministrin do të jetë 2950 euro.



MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Si të kuroni dhimbjet
e kokës me
lulen e murrizit

KESHILLA



9 simptomat që
tregojnë se vuani nga
infeksionet në veshka

Arqile Gjikondi:



◆ Mjeku nefrolog-
internist: Rreth
85% e pacientëve
kurohen plotësisht
nga sëmundja

Si kryhet mjekimi me antibiotikë i prostatitit kronik

"Operacioni i prostatës
nuk i jep fund dhimbjeve"

Ja pse duhet të konsumoni sa më shumë kajsi



“Pacientët mund t’i ndaj në 3 grupe të mëdha. Grupi më i madh, rreth 50-60% i pacientëve ndiejnë përmirësim të jashtëzakonshëm deri në zhdukje të simptomave, sidomos simptomat e dhimbjeve urogenitale, përmirësim të problemeve të zorrëve ose hemoroideve (nëse kanë).

Mjeku nefrolog-internist: Rreth 85% e pacientëve kurohen plotësisht nga sëmundja

Voltiza Duro

Arqile Gjirkondi:

Si kryhet mjekimi me antibiotikë i prostatitit kronik

“Operacioni i prostatës nuk i jep fund dhimbjeve”

Prostatiti kronik është një sëmundje që prek meshkujt dhe mund të ndodhë e të zhvillohet edhe më tej pa u kuptuar nga pacientët. Në një intervistë për suplementin “Life Pages” në Gazeta Shqiptare mjeku nefrolog-internist, Arqile Gjirkondi tregon se 85% e të sëmurëve arrijnë të kurohen plotësisht nëpërmjet rrugës rectale me antibiotikë. Më tej mjeku bën me dije se rreth 15% e pacientëve (me histori të gjatë të sëmundjes 5-20 vjet, ose që kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale) nuk ndiejnë përmirësime gjatë 10 seancave të para. Gjirkondi thekson se asnjëherë operacioni i prostatës nuk është zgjidhje për eliminimin e dhimbjeve apo simptomave të tjera të prostatitit kronik, përkundrazi, mund ti përkeqësojë më tej ato.

Shumë pacientë që vuajnë nga prostatiti kronik, kurohen në rrugë rectal me antibiotikë. Sa i efektshëm është ky trajtim?
Në praktikën time mjekësore prej afro 10 vjetësh me 500 pacientë të mjekuar në rrugë rectal me antibiotikë dhe anal heater (të cilët janë ndjekur në periudha 1-8 vjet); më rezultojnë se 85% e tyre shërohen plotësisht. Kjo duke përdorur 10 seanca mjekimi rectal dhe më pas 3-6 javë mjekim oral me antibiotikë.

Si kategorizohen pacientët që kurohen në këtë mënyrë?
Pacientët mund t’i ndaj në 3 grupe të mëdha. Grupi më i madh, rreth 50-60% i pacientëve ndiejnë përmirësim të jashtëzakonshëm deri në zhdukje të simptomave, sidomos simptomat e dhimbjeve urogenitale, përmirësim të problemeve të zorrëve ose hemoroideve (nëse kanë). Pacientët e grupit të parë kanë edhe përmirësim të ereksionit apo ejakulacionit. Pas mjekimit rectal

këta pacientë marrin edhe mjekim me kombinim oral antibiotikësh. Përgjithësisht nuk kanë nevojë për mjekim të mëtejshëm. Mund të kenë relapse të lehta brenda 6 muajve të parë, e më pas mund të paraqiten në klinikë mesatarisht çdo 2-4 vjet për relapse të vogla. Në këtë grup zakonisht bëjnë pjesë pacientë me histori të shkurtër të sëmundjes, 1-3 vjet.

Cilët persona janë pjesë e grupit të dytë?

Grupi i dytë përbën rreth 20% të pacientëve, të cilët nuk ndiejnë përmirësime të dukshme të simptomave brenda 10 seancave, por përmirësohen mjaft mirë pas mjekimit oral 3 javor me antibiotikë. Kanë relapse të lehta por më të shpeshta dhe kanë nevojë për mjekime orale 3 javore, çdo 4-6 muaj. Përgjithësisht pas 1 viti shërohen dhe bëjnë jetë normale (pa dhimbje, pa çrregullime urinare, seks normal). Relapsat zakonisht shpërthejnë në rastet



Mjeku nefrolog-internist, Arqile Gjirkondi

e acarimit të sëmundjeve të zorrës, hemoroideve, (konstipacion, por sidomos diarre e zgjatuar), ose në rastet e periudhës së plazhit, kur qëndrojnë shumë në ujë deti

E rëndësishme është që mjekimi rectal të fillojë sa më herët që të jetë e mundur. Një pjesë të madhe të suksesit të mjekimit të prostatitit kronik, unë ia dedikoj përdorimit të antibiotikëve orale të kombinuar (gjithmonë 3 lloj antibiotikësh) për 3-6 javë shoqëruar me suposte rectal

ose pishinë.

A ka një kategori pacientësh që nuk kanë përmirësime pas trajtimit me antibiotikë?

Normalisht që po! Grupi më i vështirë përbën rreth 15% të pacientëve me histori të gjatë të sëmundjes 5-20 vjet, ose që kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale në prostatë, varicet testikulare, ose zona të tjera urogenitale. Shpesh këta persona vuajnë me sëmundje kronike të zorrëve, hemoroide kronike, sëmundje testikulare (varice, kiste të testeve striktura uretrale, dëmtime të kordonit spermatic etj). Këta pacientë tipikisht nuk ndiejnë përmirësime gjatë 10 seancave të para, po ash-

tu edhe pas mjekimit 3 javor me antibiotikë orale. Në këto raste unë përdor edhe 10 seanca të tjera mjekim rectal, pas të cilit fillon përmirësimi gradual i simptomave, dhe zakonisht pas 1-1.5 vitesh këta pacientë i kthehen jetës krejt normale.

Kur rekomandohet që të fillohet mjekimi rectal?

E rëndësishme është që mjekimi rectal të fillojë sa më herët që të jetë e mundur. Një pjesë të madhe të suksesit të mjekimit të prostatitit kronik, unë ia dedikoj përdorimit të antibiotikëve orale të kombinuar (gjithmonë 3 lloj antibiotikësh) për 3-6 javë shoqëruar me suposte rectal. Asnjëherë në praktikën time 16 vjeçare nuk më është dashur të përdor medikamente kundër dhimbjeve (amitriptiline, morfinë apo edhe medikamente të tjera të fuqishme).

A është një zgjidhje ndërhyrja kirurgjikale në prostatë për trajtimin e prostatitit kronik?

Pothuajse asnjëherë operacioni i prostatës nuk është zgjidhje për eliminimin e dhimbjeve apo simptomave të tjera të prostatitit kronik, përkundrazi, mund ti përkeqësojë. Përdorimi i kombinuar i antibiotikëve gjithmonë është i mjaftueshëm për lehtësimin dhe shërimin e simptomave të prostatitit kronik, dhimbjeve kronike pelvike. Gjithmonë ka një dritë në fund të tunelit për pacientët.

|| Në momentin e parë që konstatojmë se kemi një dhimbje koke të çfarëdoshme, duhet të pimë një gotë ujë më mjaltë ose thjesht një gotë me ujë. Gjithashtu, në rastet e dhimbjes së kokës, edhe uthulla e mollës do të ndihmonte shumë pasi ngacmon menjëherë në moment sistemin nervor, e aktivizon, e mobilizon për punë dhe nuk lejon fryrjen e zgjatimeve nervore.

Voltiza Duro

Në jetën e përditshme njerëzit mund të kenë dhimbje koke, e cila shfaqet në pjesën e pasme të saj, por si fillim nis mbi kavitetin nazal, pra mbi hundën, në pjesën e ballit ose mbi sy. Mund të themi që koka jep dhimbje edhe kur shoqërohet me temperaturë të lartë në pjesën e sipërme të saj, por mund të bëhet edhe e ftohtë. Edhe nëse personi ecën në një ambient me temperaturë të ftohtë e era është e fortë e godet, veçanërisht pjesën e fytyrës. Edhe qëndrimi para një ekrani shumë të madh televizori mund të japë dhimbje koke gjithashtu si dhe dritat e forta që nuk janë në këndin e përshtatshëm për sytë dhe sistemin nervor. Kështu rekomandohet që drita për të lexuar të ketë një kënd rënies nga ana e majtë dhe këndin e ngjitjes nga e djathta. Nëse lexojmë në këto kushte, mund të rrimë para një libri edhe 6-7 orë dhe mos të kemi asnjë problem me dhimbjen e kokës. Dhimbjet e kokës mund të shfaqen edhe nga konsumimi i tepërt i pijeve alkoolike, e veçanërisht verës e cila çliron një gaz sulfuror që depërton në gjak e godet qelizat nervore. Pra, janë një sërë faktorësh që ndikojnë në shfaqjen e dhimbjes së kokës e nëse gjejmë shkakun mund ta eliminojmë.

TRAJTIMI POPULLOR
Në momentin e parë që konstatojmë se kemi një dhimbje koke të çfarëdoshme, duhet të pimë një gotë ujë më mjaltë ose thjesht një gotë me ujë. Kjo ka kuptimin e saj fiziologjik pasi mund të ndodhë që përqindja e ujit në tru të ulet, e kështu dominojnë disa substanca të tjera që janë toksike e kryejnë pasqyrimin e informacionit. Gjithashtu, në rastet e dhimbjes së kokës, edhe uthulla e mollës do të ndihmon të shumë pasi ngacmon menjëherë në moment sistemin nervor, e aktivizon, e mobilizon për punë dhe nuk lejon fryrjen e zgjatimeve nervore. Nëse nuk qetësohet në këtë mënyrë, duhet të analizohet imtësisht faktori që ndikon në shfaqjen e dhimbjes. Kur personi ka dhimbje në pjesën e pasme të kokës, këshillohet që të bëjë një masazh në zonën e qafës me vaj sinapi, vaj liri, vaj ulliri për të lehtësuar qarkullimin e gjakut dhe për të liruar zgjatimet e nervave. Kur dhimbja shfaqet në pjesën ballore të kokës, e madje personi ka



Mjeku popullor: Si të veproni kur vuani nga migrena, përdorimi i lules së murrizit

Ylli Merja:

Si të kuroni dhimbjet e kokës me çajrat çudibërës

"Konsumoni një gotë ujë me mjaltë dhe uthull molle"



Ylli Merja

edhe bllokim hundësh, kjo do të thotë që pacienti vuan nga sinoziti e një çaj për këtë të fundit e dy pika vaj dafine, mund të japin efekte të mrekullueshme. Edhe kur truri nuk merr mjaftueshëm oksigjen, individit mund të ketë dhimbje koke. Gjithashtu, edhe niveli i lartë i kolesterolit në gjak, mund të shkaktojë dhimbje koke, e për këtë mjafton të merret lulja apo fruta e murrizit që ndihmon në shkrirjen e pllakëzave të yndyrave dhe balancimin e sistemit nervor e qarkullimin e gjakut. Edhe çaji me fruta pylli përmban antioksidantë, por edhe acide organike që ndihmojnë në qetësimin e dhimbjeve të kokës, pasi ushqen sistemin nervor.

MIGRENA DHE TRAJTIMI I SAJ
Migrena shkaktohet nga mung-

stimulojnë sëmundjen. Të tjera shkaqe janë anemia, mungesa e vitaminës B, pagjumësia, stresi dhe problemet me qarkullimin e gjakut. Megjithëse migrena është një sëmundje që nuk kurohet, ajo parandalohet dhe me anë të mënyrës së ushqyerjes mund të evitoni shfaqjen e saj. Hapi i parë është: individët që vuajnë nga migrena të konsumojnë shumë ujë gjatë ditës, minimumi 1.5 litra në ditë. Kështu qelizat e trurit do të jenë të hidratuara mjaftueshëm. Hapi i dytë është masazhim i qafës me vajra esenciale që rregullojnë qarkullimin e gjakut, të paktën 1-2 herë në javë. Vaji i sinapit dhe vaji i mentes kanë efekte qetësuese dhe rregullojnë qarkullimin e gjakut që shkon në tru. Pjesë shumë e rëndësishme është edhe mënyra e të ushqyerit, pasi sa më shëndetshëm të hani, aq më pak shfaqet migrena. Gjithashtu, gjumi është tepër i rëndësishëm, jo vetëm për mirëfunksionimin e trurit, por për gjithë organizmin. Kur fillon dhimbja e kokës duhet të konsumoni sa më shumë lëngje, sidomos çajrat janë shumë të këshillueshme, pasi zgjerojnë enët e gjakut, dhe veprojnë si qetësues natyral të trurit. Një çaj shumë efektiv për dhimbjet e kokës përgatitet kështu: në 2 litra ujë zieni 2 minuta 1 lugë mente, 1 lugë barblete, 1 lugë borzilok, 1 lugë rozmarine, 1 lugë lule basani, 1 lugë mendër si dhe 1 lugë murriz lule ose frutë. Konsumoni 3-4 gota çaj në ditë kur keni dhim-

bje koke. Pas kësaj duhet të konsumoni 10-20 fije shafrani në ditë, pasi ky përmban antioksidantë të fuqishëm, grupin e vitaminave B1, B2 dhe B6 që janë ushqyes të trurit, dhe piko krocine dhe krocine të cilat veprojnë si qetësues të trurit dhe largojnë radikalet e lira në organizëm. Boronica dhe xhenxhefli ushqejnë sistemin nervor, zgjerojnë enët e qarkullimit të gjakut dhe ndalojnë të vjelat, pra është me shumë interes që 4-5 ditë e dhimbjes së fortë të kokës, këto bimë të përdoren në mënyrë intensive. Kurse në ditë e tjera këshillohet të përdorni vazhdimisht borzilokun, qoftë si erëz kuzhine, qoftë si një çaj të lehtë. Rrënja e valerianës këshillohet të përdoret në rastet kur migrena shkakton pagjumësi dhe të vjella pasi kjo bimë është një qetësues natyral shumë i efektshëm për dhimbjet e kokës që përdoret gjerësisht edhe në ilaçe. Ndërkohë, vajrat esenciale janë shumë efektive për qetësimin e dhimbjeve të kokës, pasi ato veprojnë shpejt. Një mikser vajrash që mund të përdoret 5-6 pika në ditë është: 5 ml vaj livando, 3 ml vaj mente, 1 ml vaj borziloku, 1 ml vaj mendër e butë si dhe 10 ml vaj ulliri.

9

simptomat që tregojnë se vuani nga infeksionet në veshka

Nëse keni pasur in-
feksione të traktit
urinar, mund të ar-
rini t'i dalloni simptomat e
bezdishme të tyre: djegie
kur urinoni dhe nevoja për
të shkuar në tualet gjatë
gjithë kohës. Por këto sim-
ptoma janë, gjithashtu,
edhe tregues të një tjetër
problemi serioz shëndetë-
sor: infeksionit në veshka.
Ndërsa infeksionet në vesh-
ka janë të rralla tek njerëz-
it e shëndetshëm, shumic-
a e tyre nisin si infektion
i traktit urinar. Por mund të
bëhet fjalë edhe për një in-
feksion që ngjitet nga
fshikëza drejt veshkave, i
cili mund të trajtohet lehtë-
sisht me antibiotikë orale
për rreth një javë. Por në
raste të rralla, një infeksion
i patrajtuar i veshkave
mund të përparojë drejt një
goditjeje që mund të rezul-
tojë fatale. Kështu, nëse
po përjetoni simptoma të
pakëndshme të një in-
feksioni të traktit urinar, duhet
të shkoni për një vizitë
pranë mjekut specialist.
Nëse filloni të vini re ndon-
jë prej simptomave të më-
poshtme, mund të jeni të
riskuar për të zhvilluar një
infeksion në veshka.

DHIMBJE GJATË URINIMIT

Është një simptomë e za-
konshme tek gratë, e ha-
sur gjatë infeksioneve
mykotike dhe vaginale. In-
flamacioni i shkaktuar
përgjatë uretrës e shkakton
atë ndjesi djegieje kur sh-
kon në tualet.

FREKUENCAT E URIN- IMIT

Jo vetëm që ndiheni sikur
doni të shkoni në tualet 20

herë në ditë, por ju shkoni dhe
uriloni shumë pak. Fshikëza juaj
është projektuar që të mbajë
shumë urinë. Por nëse fshikëza
është e infektuar si rezultat i
ndonjë inflamacioni, ky irrimim ju
bën të mendoni se keni nevojë
gjatë gjithë kohës të shkoni në
tualet.

URGJENCË PËR TË URINUAR

Bëhet fjalë për atë ndjesinë sikur
duhet të urinoni dhe duhet ta bëni

urgjent. Është i njëjti irrimim që ju
bën të ndiheni sikur duhet të sh-
koni gjatë gjithë kohës në tualet
që ju bën t'ju duket sikur duhet
të urinoni menjëherë.

ETHE

Personat me infeksion në vesh-
ka shfaqin simptoma të etheve,
djerstijes gjatë natës dhe shenja
të tjera që i bëjnë të predispo-
zuar ndaj një infeksioni sistemik
**DHIMBJE SHPINË, MESI
APO NË RRËZËT E**

KOFSHËVE

Veshkat ndodhet në zonën e
thellë mes muskujve të shpinës
dhe zonës së sipërme të barkut.
Nëse dikush ju bie lehtë në atë
zonë, ju tentoni të kërceni për-
jetë nga dhimbja. Kjo për shkak
se veshkat tuaja janë në një kap-
sulë ku nuk ka shumë hapësirë
kështu që nëse ndodh inflama-
cion, është tepër i dhimbshëm.

DHIMBJE BARKU

Disa persona me infektion vesh-

kash mund të përjetojnë edhe
dhimbje barku, të cilat ndon-
jëherë mund të jenë edhe të
mprehta.

NAUZZA DHE TË VJELLA

Në të njëjtën mënyrë që një in-
feksion i veshkave mund të sh-
kaktojë simptoma sistematike si
ethet dhe të dridhurat, gjithashtu
mund të shkaktojë shqetësime
në stomak dhe ndjesi të vjellash
që shoqërojnë zakonisht infeksio-
net.

SEKRECIONE OSE GJAK NË URINË

Në shumicën e rasteve këto
shenja dallohen vetëm përmes
analizave të urinës. Kjo ndodh
sepse uretra juaj është e prekur
nga inflamacioni dhe mund të keni
pak gjakrrjedhje. Megjithatë ju
mund të vëreni gjakderdhje edhe
kur shkoni në banjë. Përsa i për-
ket sekrecioneve në formën e
qelibit, kjo është e zakonshme në
infeksionet e avancuara të vesh-
kave që shfaqen si qelizat të
bardha në provën e vajit.

URINË E TURBULLT DHE ME AROMË TË RËNDË

Nëse keni shkarkesë sekre-
cionesh në urinë, kjo mund të jetë
shenjë e infeksioni veshkash. Aro-
ma e rëndë dhe turbullira flasin
për rritjen e baktereve dhe qelizave
të bardha që ju mund të shihni.



Këshilla



Efektet kurative të rigonit të kuq

Rigoni është një barishte aromatike plot shije, por rigoni i kuq është tejet i njohur për aftësitë e tij të mrekulueshme. Ky i fundit i jep nuanca të shijshme çdo gatimi, e përputhet mirë me domaten, patëllxhanin dhe produktet e mishit. Mund të hidhni pak rigon në vezët e rrahura ose sallatë dhe të përfitonit një shije tjetër. Rigoni i kuq dhe rigoni i zakonshëm janë të

dy burime të pasura të vitaminës K, që është shumë e rëndësishme për organizmin. Kjo bimë përmban dy vajra esenciale që kanë aftësinë të luftojnë bakteret dhe në shumë raste janë më efikase se vetë medikamentet e madje përmban thimol dhe një acid të quajtur rozmarinik. Tek rigoni i kuq përmbajtja e këtyre dy substancave është edhe më e lartë. Të dy shërbejnë si antioksidantë. Në një gram rigon gjenden 42 herë më shumë antioksidantë se në një gram mollë e ai përmban 30 herë

më shumë antioksidantë se në një gram patate. Të dy varietetet e rigonit janë të pasur me hekur, mangan dhe minerale të tjera të rëndësishme për shëndetin e njeriut. Rigoni është i pasur në fibër, po aq sa çikorja e është një burim natyral i acideve yndyrore Omega-3. Gjethet dhe kërcelli janë anti-septikë, ndihmojnë me sekrecionet e tëmthit dhe rrisin prodhimin e djersës, ndërsa pijet ose çajrat e rigonit ndihmojnë kundër të ftohtit, virozës, temperaturës, mungesës së tretjes, problemeve në stomak ose simptomave menstruale. Ju mund të përgatitni çaj me gjethet e njoma ose të thara të rigonit.

Grirja ose shtypja e gjetheve përpara përgatitjes së çajit, ndihmon në çlirimin e shumë prej përbërësve kryesorë të rigonit në ujë. Shtypni tri lugë çaji me gjethet e rigonit ose 1 lugë çaji me gjethet të thara dhe hidhni në një filxhan me ujë të valuar. Mabajni për 5 deri në 10 minuta. Çaji i rigonit mund të jetë i hidhur, por, nëse shtoni mjaltë, shija e tij do të ëmbëlsohet.



Ja pse duhet të konsumoni sa më shumë kajsi

Kajsia është një frutë, e cila njihet për vlera të mira ushqyese, të cilat kanë në përbajtjen e tyre vitaminë A, B1, B2, PP, C, acide organike, pektinë, albumina, sheqerna rreth 14%, etj. Ajo mund të cilësohet si një bimë e rëndësishme shëndetësore kjo për faktin se nuk është vetëm frutë e shëndetshme, por gjethet dhe degët e saj kanë veti të ndryshme të shëndetshme. Kajsia mund të përdoret e freskët ose e thatë, e përpunuar në trajtë reçeli, kompostojë dhe lëngu të këndshëm. Fruta e freskët e kajsisë ndihmon në prodhimin e gjakut, si dhe është, gjithashtu, shumë i mirë edhe për qetësimin e muskujve të tendosur dhe bën mirë për zërin e ngjitur. Frutat e thata kanë rreth 60% sheqer, kurse thelpnjtë e tyre janë të pasur me albumina deri në 28%, vajra deri në 55%, etj, edhe përdoren me efekt kundër dhimbjes së kokës. Për këtë qëllim, ato pihen dhe konsumohen me mjaltë, për t'u tretur më mirë. Sëmundjet, të cilat kanë efekte parandaluese nga kajsia janë: dhembjet në gjoks, anemia, sëmundjet kanceroze, migrena, epilepsia si dhe sëmundjet e mëlcisë. Ndërsa bërthamat e kajsisë përdoren kundër dhimbjes së kokës e për këtë qëllim ato hahen me mjaltë për t'u tretur më lehtë. Por të konsumosh sa më shumë kajsi gjatë verës do të thotë të mbrosh sa më shumë lëkurën nga rrezet e dëmshme të diellit. Kajsia ka në përbërjen e saj vitaminën A, e cila ka rol mbrojtës ndaj diellit dhe sulmeve që vijnë nga jashtë.



SHKRIMTARET DHE ARTISTET NE DIKTATURE

Ekskluzive / Zbulohet raporti i vitit 1973 mbi situatën, repertorin, shfaqjet dhe aktorët e Teatrit Popullor

Kur Byroja Politike alarmohej për gjendjen në Teatrin Popullor

Raporti: "Mima ka përfituar 2.428 lekë nga recitalet në Radio-Televizion, dhe si ai, edhe Kristofori, Pitarka, Basha, Trebicka, Karma dhe Prifti"

Nga Dashnor Kaloçi

Ashtu siç kemi vënë re në mjaft dokumente arkivore të pasqyruar në kapituj të këtij libri dhe jo vetëm, duket se udhëheqja e lartë e PPSH-së dhe të gjitha strukturat e tjera në varësi të saj, nga të gjitha institucionet kulturore dhe artistike të Tiranës dhe gjithë vendit, i kanë kushtuar një vëmendje dhe prioritet të veçantë Teatrit Popullor. Ashtu si "La Scala" e Milanos, Opera Shtetërore e Vjenës, apo "Balshoj Teatër" i Moskës etj., duket se "Meka" e kulturës në Shqipëri gjatë gjithë periudhës së regjimit komunist të para viteve '90-të, është konsideruar dhe ka qenë realisht Teatri Popullor në Tiranë. Brezi i atyre shqiptarëve që e kanë jetuar në moshë madhore periudhën e viteve 1960-'70-të, e mbajnë mënd shumë mirë se teatri asokohe ishte bërë pjesë e pandarë e jetës së tyre aq sa me të drejtë mund të thuhet se teatromania ishte bërë kryefjala e propagandës së regjimit komunist në fuqi. Aq në modë ishte teatri në atë kohë, sa që aktorëve i duhej të dilnin në skenë pothuaj të gjitha ditët e javës gjatë gjithë vitit, duke pasur vetëm një ditë pushimi në javë. Ose më saktë po t'ju referohemi shifrave të dokumenteve arkivore, vetëm në vitin 1972, aktorët e Teatrit Popullor kanë dalë në skenë për të dhënë shfaqje plot 284 ditë të atij viti. Kjo për sa i përket anës sasimore të shfaqjeve, ndërsa lidhur me përmbajtjen, cilësinë dhe gjithë problematikën që përmbante Teatri Popullor (por dhe ato të rretheve), në analizat e punës së tij merrte pjesë vazhdimisht një nga anëtarët e Byrosë Politike të PPSH-së, si p.sh. në një nga mbledhjet e fillimit të vitit 1973, aty ka marrë pjesë Xhaferr Spahiu, një nga figurat tepër të njohura të udhëheqjes komuniste të asaj kohe, ish-sekretar i Komitetit Qendror të PPSH-së dhe zv/kryeministër. Kjo gjë veç të tjerash si duket ka ardhur edhe për vetë impaktin e madh që kanë pasur në jetën e vendit aktorët e Teatrit, aq sa në atë kohë ata njiheshin dhe gëzonin një popullaritet më të madh edhe se vetë anëtarët e Byrosë Politike të Ko-

mitetit Qendror të PPSH-së. Kjo gjë, pra vëmendja dhe prioriteti që i kushtonte asokohe regjimi komunist në fuqi teatrit me anë të mjeteve të saj të propagandës, veç të tjerash duket edhe nga numri i madh i dokumentesh arkivore që gjenden në Fondin 14 të Arkivit Qendror të Shtetit (Aparati i Komitetit Qendror të PPSH-së), ku janë me qindra raporte, informacione, relacione, letra, analiza, mbledhje, etj. etj., ku bëhet fjalë vetëm për teatrin. Edhe dokumenti në fjalë që po publikojmë me shkurtime në këtë kapitull të këtij libri, është një raport-informacion prej 25 faqesh me konkluzionet e një ekipi të Ministrisë së Arsimit Kulturës për disa nga institucionet kulturore dhe artistike të Tiranës, ku pjesa më e madhe i kushtohet Teatrit Popullor.

KONKLUZIONE TE EKIPIT TE MINISTRISE SE ARSIMIT DHE KULTURES MBI GJENDJEN E INSTITUCIONEVE ARTISTIKE TE TIRANES PER VITIN 1973 DHE DISA PROBLEME TE DREJTIMIT TE TYRE NGA ANA E KOMITETIT EKZEKUTIV TE KP TE TIRANES

Një ekip i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës kontrolloi veprimtarinë e vitit 1973 në Teatrin Popullor, në Teatrin e Estradës, në Cirk dhe në Teatrin e Kukllave. Paralelisht u pa edhe udhëheqja e tyre nga ana e seksionit të kulturës të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit

Së shpejti libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët në diktatin komunist" i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi



Prokop Mima

të Tiranës. Ekipi u njoh konkretisht me aktivitetet e këtyre institucioneve në drejtim të përmbajtjes dhe nivelit ideo-artistik të veprimtarisë së zhvilluar, të punës që është bërë për edukimin ideologjik e profesional të punonjësve, si dhe problemet e drejtimit të tyre.

Për këtë qëllim, ekipi morri takime me shokë të seksionit të kulturës të Komitetit Ekzekutiv, me drejtuesit dhe udhëheqjen artistike, këshillat artistike, kolektivat artistike dhe punonjësit e tjerë të këtyre institucioneve, asis-

toi në shfaqje dhe prova që u zhvilluan gjatë kësaj periudhe, studjoi dokumentacionin dhe repertorin ekzistues, organizoi konsulta dhe takime me specialist dhe forcat krijuese, ballafaqi mendimet në reparte dhe në udhëheqjen artistike e shtetërore. Në përfundim dhe konkluzionet përkatëse për çdo institucion. Nga e gjithë puna e zhvilluar, ekipi arriti në këto përfundime:

Trupat artistike profesionale të Tiranës, (Teatri Popullor; Teatri i Estradës, Cirku dhe Teatri i Kukllave), të frymëzuara nga



Aktorët e Teatrit Popullor në vitet 70



Teatri Kombëtar

fjalimet e fundit të shokut Enver, vendimet e Plenumit të 4-të të Komitetit Qendror të PPSH-së, "Mbi luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre", të cilat u zbërthyen në aktivet e partisë të rrethit e të rajoneve dhe të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit, gjatë vitit 1973 kanë arritur një sërë rezultatesh në punë për zhvillimin e mëtejshëm të artit tonë socialist dhe në vënien e tij në shërbim të edukimit ideo-estetik të masave.

"TEATRI POPULLOR KA VENE PIRRO MANIN TE BASHKEPUNOJE ME DRAMATURGUN BASHKIM KOZELI"

Duke bërë spastrimin e tij nga pjesët e papërshtatëshme që ishin ndikuar nga influencat e huaja, për të siguruar një repertor sa më militant dhe me frymë të shëndoshë socialiste dhe kombëtare. Si rrjedhim, Teatri Popullor, hoqi nga repertori shtatë vepra të tilla dhe nëpërmjet rivënies, rrifreskimeve dhe dublimit të roleve në disa nga pjesët tona nacionale, brenda një kohe të shkurtër siguroi një repertor prej 10 veprash.

Ka përpjekje dhe janë shënuar rezultate në ngritjen e nivelit artistik të shfaqjeve. Teatri Popullor realizoi me një nivel shumë të lartë ideo-artistik rivëniet për dramën "Sinjali i kuq" dhe komeditë "Prefekti". Përpjekjet për repertorin po vazhdojnë. Kështu, p.sh. pavarësisht se Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit nuk ka aprovuar akoma planin tematik dhe repertorin, Teatri Popullor po rivë paralelisht dramën "Familja e peshkatari", dhe "Toka jonë".

Një punë e mirë po bëhet me autorët. Kështu p.sh. Teatri Popullor ka vënë shokun Pirro Mani të bashkëpunojë me dramaturgun Bashkim Kozeli për dramën "Rrufjanët". Po kështu është ndihmuar me vërejtje bindëse dhe duke i vënë si konsulent gjatë procesit të ndreqjeve shokun Naim Frashëri, autorit Hamza Minarolli për



dramën "Gjuhët e pushkës", etj.

TEATRI POPULLOR NE RAPORT PARA XHAFERR SPAHIU

Teatri Popullor dha 284 shfaqje nga 238 që realizoi në vitin 1972 dhe rriti numrin e spektatorëve në 144.000, nga 100.000 që kishte vitin e kaluar.

Hartimi, shqyrtimi dhe aprovimi i repertorit është zvarritur. Teatri Popullor ndonëse e ka paraqitur planin tematik qysh me 27 dhjetor 1973, akoma nuk ka marrë përgjigjeje. Institucionet e Tiranës po ecin akoma pa një plan tematik të aprovuar e të njohur zyrtarisht. Kjo nuk përputhet me orientimet e Komitetit Qendror të PPSH-së dhe të Qeverisë për forcimin e kontrollit paraprak në fushën e botimeve dhe të ekzekutimeve. Përvëq Ministrisë kjo detyrë i vu në dukje shokëve të kryesisë së Komitetit Ekzekutiv nga shoku Xhaferr Spahiu me 30 nëndor 1973 kur ishte në raport Teatri Popullor.

Kur u analizuara në Komitetin Ekzekutiv më datë 22.XII.1973 vepimtaria e Teatrit Popullor dhe Estradës së Tiranës, Kryetari dha porosi që menjëherë të mblidheshin dramaturgët nga Komiteti Ekzekutiv dhe kjo detyrë u zvarrit shumë, aq sa edhe kur u tentua të mblidheshin, takimi me ta nuk u realizua. Në repertorin aktiv të Teatrit Popullor mungon tema e klasës punëtorë, ajo e transformimeve socialiste në Bujqësi, dhe Luftës Nacional-Çlirimtare. Për shtatë vjet me rradhë, ky teatër nuk ka dhënë asnjë shfaqje për fëmijë, që në bazë të urdhërit të Ministrisë, duhet të vërë një në vit.

U PEZULLUAN DRAMET E PETRO MARKOS E NNDREK LUCES PER GABIME IDEORE

Megjithtë kujdesin e madh që është treguar për pastërtinë ideologjike të veprave e materialeve të tjera artistike që vihen në skenë gjatë vitit 1973 në Teatrin Popullor, këshilli artistik aprovoi dhe filloi nga puna me dramën



"Niku i Martin Gjinit", një vepër me të meta të rëndësishme ideore e cila më pas u anulua nga organizata bazë, drejtoria, Komiteti Ekzekutiv dhe Komiteti i Partisë. Seksioni i kulturës këtë vepër duhet ta kishte lexuar me kohë dhe të mos lejonte fillimin e punës pa aprovimin e tij. E njëjta gjë ndodhi edhe me rivënien e dramës "Votra e huaj" të Ndrek Lucës.

Në Teatrin Popullor u punua dobët për rifiksimin e dramës "Fytura e dytë" dhe pati rënie në krahasim me realizimin e më-parsëshëm. Nga katër premiera që ishin në plan, janë realizuar dy rivënien, ndërsa tri janë anuluar për gabime ideore. Janë dhënë 284 shfaqje me 144.000 spektatorë dhe me 206.037 lekë të ardhura. Kanë mbetur pa u realizuar 106.964 lekë të ardhura. Dobët ka punuar për realizimin e planit në turne e fshatra, Teatri Popullor, i cili ka shkruar vetëm në Shkodër; Durrës dhe Fier, duke mos vajtur në rrethe të vogla e qëndra punëtore si Dibra, Mati, Gjirokastra, metulurgjia etj. Në fshat kjo trupë ka dhënë vetëm 17 shfaqje.

AKTORI PROKOP MIMA, KA MARR PJESE VETEM NE 55 SHFAQJE DHE MERR 2.428 LEKE NE RADIO-TELVIZION

Në Teatrin Popullor (dhe sallën Rinia) punojnë 106 veta, nga të cilët vetëm 53 janë fuqi artistike. Teatri Popullor ka disparopocion midis aktorëve meshkuj dhe femra. Në këtë trupë ka 19 aktore femra, që për shkak se dramat kanë personazhe femrash të kufizuara, ato aktivizohen shumë pak. Në trupat profesioniste të Tiranës ka fryrje të theksuar të fuqisë punëtore e cila mund të shkurtrohet. Në pra-



pavijat e këtyre institucioneve punohet pa norma dhe sorrollatje e ditë të tëra pa punë për mungesë organizimi. Më të theksuara këto ndodhin në sektorin e rrobapëqisë, marangozëve, skenografëve e piktoreve, mekanikëve, rrob-arësve magazinierëve, etj. Shkurtime mund të bëhet duke kopëruar sektorët prodhues të Teatrit Popullor, Estradës, Cirkut dhe Teatrit të Kukllave.

Ekipi i Ministrisë e konstatoi disa shkelje të së drejtës për të marrë amatorë në shfaqje e recital. Shpesh herë janë tërhequr në recital persona të jashtëm e të brendshëm si: këpucarë, magazinierë, pastruesja, etj, ndërsa lihen pa u angazhuar vetë aktorët që nuk kanë role. Kjo praktikë nuk i sjellë asnjë dobi nivelit të shfaqjeve në Teatrin Popullor, ndërsa i jepet rrugë shpërbllimit me recital të punonjësit të brendshëm të prapavijës, disa artistë profesionistë

shkojnë e marrin recital në Radio e Televizion. Aktori Prokop Mima, i cili gjatë vitit 1973 ka marrë pjesë vetëm në 55 shfaqje, ka marrë 2.428 lekë recitale në Radio-Televizion. Po kështu ndodh me aktorët Vladimir Prifti, Shkëlqim Basha, Roland Trebicka, Gjon Karma, Sulejman Pitarka, Anastas Kristofori etj.

NE TEATRIN POPULLOR KA 14 ARTISTE ME ARSIM FILLOR DHE 8-VJEÇAR

Një problem që duhet zgjidhur është ai i vendosjes së normave për artistët dhe punonjësit e prapavijës së trupave, për të cilat Ministria ka dërguar orientimet për cdo institucion. Në Estradë dhe në Teatrin e Kukllave ky problem është marrë më seriozisht dhe po ecet në bazë të normave. Teatri Popullor këtë çështje e ka zvarritur së tepërmi. Aty u ndeshëm me koncepte intelektualiste kundër vendosjes së normave dhe u vu në lëvizje vetëm pas vajtjes së ekipit. Në Teatrin Popullor ka 14 artistë me arsim fillor dhe 8-vjeçar dhe asnjë prej tyre nuk ndjek shkollën. Nga ana jonë në bashkëpunim me drejtoritë janë përcaktuar konkretisht detyrat për arsimimin e artistëve që duhet të fillojnë në shtator të këtij viti. Këtë problem ta ndjeko dhe kontrollojë edhe sektori i Kulturës.

Ka shumë anomali në mbajtjen e dokumentacionit në të gjitha institucionet. Nga kontrolli i bërë rezultojn se dokumentet kanë të meta të rëndësishme. Për vite të tëra nuk janë pasqyruar ndryshimet që kanë pësuar punonjësit. Për asnjë rast nuk janë bërë karakteristika pune. Disa kuadrove të

transferuar qoftë edhe me masa ndëshkimore nuk u janë dërguar dokumentet dhe karakteristikat e përkatëse atje ku punojnë tani. P.sh. në Teatrin e Estradës, Bujar Kapexhiut nuk i është bërë asnjë karakteristikë me rastin e heqjes së tij nga ky institucion. Po në Estradë ka mbi pesë kuadro të transferuar që doçjet e tyre qëndrojnë akoma aty, ndërsa për dy të tjerë, të emëruar po prej disa muajsh, nuk janë marrë akoma dokumentet e përkatëse. Si në Estradë, Cirk dhe në Teatrin Popullor, në flet-anketat personale të kuadrove nuk janë pasqyruar ndryshimet. Tipik ishte rasti i artistes Mel-pomeni Çobani, që qysh nga viti 1948 nuk i ishte pasqyruar asnjë ndryshim që e ka pasur ajo në jetën e saj.

DRAMATIZIMI I ROMANIT "LUMI I VDEKUR", 15 DITË PER T'U SHUMFISHUAR


Komiteti Ekzekutiv ka marrë në analizë dy herë gjëndjen e Estradës dhe njëherë Teatrin Popullor, duke ndikuar kështu për një përmirësim të mëtejshëm të gjëndjes. Por, këto analiza do të ishin në të efektshme nëse seksioni i kulturës do ta kishte evidencuar më të plotë e të qartë gjëndjen e këtyre institucioneve në raportet e paraqitur. Kështu Komitetit Ekzekutiv do t'i krijoheshin kushte për të marrë masa konkrete dhe studjuar për të mënjnauar të metat që u konstatuan. Fakti që disa nga problemet kardinale si ai i repertorit, i tematikës së tij, përbërjes së trupave, interpretimit, disa anomalive e shkeljeve etj, nuk kanë gjetur zgjidhje, dëshmon për një analizë të pathelluar.

Teatrit Popullor, sikundër është bërë gjithë trupave të tjera, akoma dhe sot nuk i është dhënë ende përgjigje për aprovimin e planit tematik të vitit 1974, dramatizimi i romanit "Lumi i vdekur" mbahet më tepër se 15 ditë vetëm për t'u shumfISHUAR. E metë më me rëndësi në punën e seksionit është se ai kërkon që të shqyrtojë e zgjidhë problemet e shumta e të ndërlikuara vetëm me forcat artistike të seksionit. Ai nuk ka tërhequr në këtë punë specialistët e aftë që ka në Tiranë. Komiteti i Kulturës dhe Arteve ka funksionuar dobët, për të mos thënë se nuk ka funksionuar fare dhe nuk është vënë si duhet në rolin e vet, gjatë vitit 1973 është mblidhur vetëm dy herë, për planin dhe në tjetërën ka shqyrtuar disa problem të institucioneve.

Teatri Popullor dhe Estrada e Tiranës do të jenë në raport në Qeveri në muajin shtator të këtij viti. Eshte detyrë e vetë këtyre dy institucioneve që në këtë analizë të venë me një bilanc sa më të pasur rezultatesh. Seksioni i Kulturës dhe Komiteti Ekzekutiv të ndjekin nga afër zbatimin në kohë të gjithë detyrave që kjo ekipi ynë në çdo institucion dhe në të njëjtën kohë të zgjidhin ato problem që varen për tyre.

Më pak se tre muaj kanë mbetur nga dita kur do të festohet 30 vjetori i Teatrit Popullor. Kjo është një ngjarje e shënuar e që duhet përkujtuar me dinjitet. Prandaj propozojmë që kryesia e Komitetit Ekzekutiv ta shqyrtojë në një mblidhje të shpejtë të saj punën e bërë deri tani, masat që duhen marrë për kohën e pakët që ka mbetur dhe të aprovojë përfundimisht programin e aktivitetëve.

Tiranë, më Mars 1974 Ekipi i Ministrisë Arsim Kulturës



Opinion

i Ditës

Pirateria dixhitale, sprova jonë e radhës

Spanja, një shembull për t'ia nisur

Nga MONIKA STAFA

(vijon nga faqja 1)

... kanë hyrë në treg bazuar mbi disa parime etike biznesi kanë vënë alarmin prej kohësh për këtë situatë që sot në Shqipëri është kthyer në një fenomen të pandalshëm vjedhjeje. Europa dhe shtete të saj kanë vite që mbështeten në publikime dhe gjetje studimore shumë interesante mbi të dhënat që jep tregu. Por shifrat që ata japin nuk mbesin në letër. Autoritetet duken se janë treguar të vëmendshme prej vitësh duke marrë masat përkatëse në bashkëpunim me institucionet përkatëse duke i rregulluar mekanizmat ligjorë në dëm të piraterisë. Po si është gjendja e këtij fenomeni në një prej shteteve evropiane që vetëm pak vite më parë kapte shifra të çmendura në piraterinë dixhitale duke i shkakuar vendit humbje të mëdha në buxhetin e vet? Spanja prej vitësh bën studimin e këtij tregu dhe kërkimet duken se kanë dhënë rezultate të para.

Në vitin 2017, vlera financiare e aksesit të paligjshëm në përmbajtjet të ndryshme që ofrojnë shërbimet audiovizive dhe online në Spanjë kapën shifrën e 21.899 miliardë eurove, duke paraqitur kështu një rënie prej 6 përqind, krahasuar me vitin 2016 dhe një rënie të akumuluar prej 9 përqind, krahasuar me vitin 2015.

Pirateria dixhitale ka pësuar një rënie në Spanjë për të dytin vit radhazi në aspektin e shifrave absolute, edhe pse përqindja e individëve që kanë akses në përmbajtjet që u vidhet e drejta e autorit mbetet e njëjtë. Kështu, në vitin 2017 u regjistruan rreth 4.005 miliardë euro prej aksesit të paligjshëm në përmbajtje që kapin një vlerë tregu prej 21.899 miliardë euro. Humbja e pësuar në këtë sektor u rrit në 4.1 përqind, duke kapur shifrën e 1.857 miliardë eurove.

Këto janë disa nga rezultatet kryesore të grumbulluara nga "Observatori për piraterinë dhe konsumin e përmbajtjeve digjitale 2017", i kryer nga një institut i paruarur kërkimesh dhe analizash i quajtur GfK (*Growth from Knowledge*). Publikimi i këtij raporti u krye nga Aleanca e Krijuesve, Industrive të Përmbajtjes dhe LaLiga (<http://www.laliga.es/>).

Carlota Navarrete, drejtore e Aleancës, pat shpjeguar në një dalje publike se trendi që ka nisur që prej vitit 2016 për të ulur piraterinë në përmbajtje, po e ruan vlerën e saj dhe megjithëse ata shprehën se janë ende larg nga numri i website-ve pirate të bllokuara si p.sh., Portugalia ka një bllokua më shumë se 800, ose Italia (rreth 450), ata besojnë se rezultatet duken të jenë pasqyrë e një angazhimi të drejtë. Kërkesat e tyre për të forcuar dhe përsërituar zbatimin e masave legjislative,



si, dhe për të rritur stafin dhe burimet teknike të Administratës Publike, gjatë kryerjes së fushatave ndërgjegjësuese, duke që mbetet një vendim shumë i mirë. Kjo nisim tregon se përpjekja e vazhdueshme e ndërmarrë nga industria për të luftuar piraterinë në të gjitha nivelet dhe rritja pothuajse e 90% e kërkesave të paraqitura përmes procedurës administrative, bënë që vitin e kaluar këto autoritete të korrnin sukses të rëndësishme në procedurat civile dhe penale. Megjithëse problemi vazhdon të mbetet ende serioz, ky përparim i lehtë në luftën kundër piraterisë është një inkurajim për të vazhduar punën duke kërkuar nga të gjithë aktorët privatë dhe publikë që të bëjnë përpjekje më të mëdha për ta luftuar atë. LaLiga nga ana tjetër, anëtare e këtij koalicioni që mbështet gjetjet e këtij studimi duket e kënaqur të vazhdojë ky lloj trendi, ai i uljes së numrit të individëve që ndjekin futbollin në faqe ilegale. Të dhënat tregojnë gjithësi se numri i tyre është zvogëluar me 5 pikë përqindje që nga viti 2015; nga 21 përqind në 2015 në 16 përqind në vitin 2017. Pas krijimit të LaLiga të një departamenti posaçërisht për luftën kundër piraterisë audiovizive dhe mbrojtjen e të drejtave audiovizive, LaLiga ka bllokuar 12 website në internet.

AKSESI I PALIGJSHËM, TË ARDHURAT DHE QËNDRIMET

Përqindjet e individëve që kanë akses të paligjshëm në përmbajtje ndahen në ata që ndjekin muzikë (22%), filma (33%), video lojëra (11%), libra (24%), seriale televizive

(30%) dhe futboll (10%). 1.857 miliardë euro lëvizin të ardhurat prej piraterisë si p.sh.: muzika 507 milionë, filma 453 milionë, seriale televizive 167 milionë, libra 203 milionë, videogame 242 milionë dhe futboll 285 milionë. 51 përqind e konsumatorëve që kanë qasje në përmbajtjet e paligjshme argumentojnë se përmbajtja origjinale është shumë e shtrenjtë ndërsa 43 përqind e tyre thonë se aksesit tek këto përmbajtje është shumë i shpejtë dhe i lehtë. Sipas studimit të gjitha këto përqindje janë më të larta në krahasim me ato të vitit 2016. Ndërsa 25 përqind e tyre mendojnë se nuk po bëjnë kurrfarë dëmi ose mendojnë se nuk ka pasojë ligjore për ata që piratojnë, dhe që këndej asgjë nuk ndodh.

Edhe pse këto gjetje kanë dalë nga një institut serioz kërkimesh dhe analizash dhe ky nuk është viti i parë që realizohet ky lloj studimi me temë mbi piraterinë, kjo gjë dëshmon se ende lind nevoja prej autoriteteve për të dërguar mesazhe të qarta për këtë çështje. Përveç kësaj, sipas rezultateve të studimit të mësipërm prej Observatorit, 15% e konsumatorëve pranojnë se kanë vështirësi të mëdha për të diferencuar faqet e ligjshme nga ato të paligjshme ndërsa një tjetër grup prej 44 përqind pranon se mund ta dallojë origjinalin me atë që bën piratin, pra që vjedh autorësinë. 68% e përdoruesve që bëjnë një lidhje interneti marrin parasysh kryesisht shpejtësinë, që mundëson qasje më të shpejtë në përmbajtje. Kjo përqindje është e njëjtë me atë të vitit 2016. Megjithatë, përqindja e përdoruesve që

vlerësojnë veçanërisht ofertën e kombinuar (shpejtësi të lartë ose fibre plus content) me ofrues të zgjedhur në internet, është rritur deri në 56% krahasuar me 51% në vitin 2016.

SI TË KEMI AKSES DHE BURIMI I TË ARDHURAVE

Sa i përket mënyrës si të kemi akses në faqet pirate, theksojmë se janë motorët e kërkimit ata, të cilët vazhdojnë të kenë peshën kryesore në kërkimin e përmbajtjeve të paligjshme, me 75%, dhe *google* është përdorur për të aksesuar në përmbajtjet pirate. Sa i përket rrjeteve sociale, 'Facebook', gjithashtu, ka pasur një akses të padis-kutuëshëm në të tilla website (83%), e ndjekur nga 'Twitter' me (42%) dhe 'Instagram' me (34%). 'Facebook' ka arritur të nënshkruajë marrëveshje të rëndësishme sa i përket industrive të ndryshme për t'u bërë burim i ligjshëm dhe për të rregulluar aksesin në përmbajtje. Përqindja e website-ve tek të cilat u aksesuan përmbajtje ilegale të financuara nga reklamata u rrit deri në 95% (67% në vitin 2016). Nga një publicitet i tillë, 68% korrespondojnë me lojërat në internet dhe faqet e basteve, 58% përcaktan vendin dhe më shumë se 55% ka një përmbajtje të rritur.

Burimi i të ardhurave i këtyre website-ve sigurohet në forma të ndryshme. Duhet theksuar se 8 nga 10 të tilla regjistruohen fillimisht si përdorues, duke i deklaruar dhe të dhënat personale të cilat piratët i mbledhin në një program të dhënash, të cilat më pas i përdorin gjatë fushatave të marketingut elektronik, duke arritur çmime shumë të larta në treg.

Faqet pirate marrin të dhëna shumë më të vlefshme sesa mund të përfytyrohet duke u mundësuar atyre të zotërojnë përfitimë të rëndësishme ekonomike, si p.sh., lundrimi në internet, preferencat, pëlqimet apo dhe blerjet online.

Mjetet e pagesës, gjithashtu, kanë një rol të rëndësishëm në drejtimin e faqeve pirate, veçanërisht në rastet kur këto vende komercializojnë llogaritë premium, marrin donacione ose standardizojnë një sistem për të dërguar mesazhe nëpërmjet celularit për përdoruesit e regjistruar, për të informuar mbi nxjerrjen në shitje të përmbajtjeve të reja në vend, etj. Konsumatorët e piraterisë së librave janë ata të cilët janë më të gatshëm të paguajnë për të shmanjur reklamata (43%), ata që përdorin videogame dhe filma (39%), seriale televizive (37%) dhe konsumatorët e piraterisë, të cilët janë më pak të gatshëm të paguajnë për të shmanjur reklamimin e muzikës përbëjnë (35%) ndërsa futbollit (34%). Përqindja e konsumatorëve, të cilët vendosin të pranojnë fushatat e komunikimit kundër piraterisë, është dukshëm në rritje krahasuar me vitin e kaluar, gjë që është një fakt shumë pozitiv që konfirmon se autoritetet në Spanjë duhet të vazhdojnë të ndjekë një linjë të tillë.

Gjithsesi, pothuajse të gjithë përdoruesit e internetit e dinë ekzistencën e ofertës së përmbajtjes ligjore në platformat e abonimit dhe modalitetet të tjera, si Netflix (91%), Spotify (81%), Movistar + (80%) ose HBO (68%), e cila i bën nul arsyet e dhëna nga përdoruesit piratë, të cilët thanë se vazhdojnë të shkelin të drejtën e autorit për shkak të mungesës së një oferte të mirë ligjore dhe me çmime të volitshme. Në këtë drejtim, vlen të përmendet se përdoruesit e internetit që janë piratë dhe gjenden të regjistruar në internet në këto platforma nuk e ndalojnë piraterinë, megjithëse piratojnë më pak në disa sektorë, si muzika.

NDIKIMI NË PUNËSIM DHE TË ARDHURAT SHITËTORE

Ndikimi i piraterisë në punësim siguron shifra shqetësuese për krijuesit dhe industrinë e përmbajtjes. Këto të fundit sot punësojnë rreth 69,861 njerëz nga 99,095 punonjës që punojnë për sektorin e kulturës dixhitale, sipas të dhënave të qeverisë spanjolle. Fondi publik në vend duket se ka dështuar në thithjen e fondeve (gati 372 milionë euro për shkak të piraterisë). Kjo do të thotë, se shteti spanjoll ka ndaluar marrjen në vitin 2017, 575 milionë euro për shkak të qasjeve të paligjshme në përmbajtje, me një shumë të akumuluar që nga viti 2012 të 3.347 miliardë eurove.

AKSESI I PALIGJSHËM NË PËRMBAJTJET MUZIKORE

Ka një rritje të lehtë të →

Dje në "Deutsche Welle"

E drejta e azilit në BE: Faktet më të rëndësishme

Nga Carla Bleiker

(vijon nga faqja 1)

... Gjermani, kur dhe si duhen trajtuar ata, janë pyetje për të cilat partitë gjermane kristian-demokrate, kristiansociale dhe socialdemokrate kanë qëndrime të ndryshme.

Por cilat janë rregullat që duhen respektuar nga të gjithë, jo vetëm në Gjermani, por në gjithë Bashkimin Europian? Ato janë direktivat e Bashkimit Europian për politikën e azilit. Se si i zbatojnë vendet e veçanta këto direktiva, si i interpretojnë ato dhe si i kthejnë në ligje kombëtare është e drejtë e secilit vend. Prandaj në disa pika ka ndryshime të mëdha midis vendeve të Bashkimit Europian.

RRREGULLI I DUBLINIT

Refugjatë që duan të kërkojnë azil në Gjermani, nuk mund ta bëjnë këtë në çdo lloj vendi. Që prej vitit 2003, ata janë të detyruar të respektojnë rregullin e Dublinit. Ky rregull thotë se refugjatët që kërkojnë azil në një vend të BE-së, duhet ta bëjnë këtë në vendin e parë që shkelin brenda BE.

Vendet anëtare nuk i përmbahen shumë këtij rregulli. Me të ashtuqajturën "Vetë-hyrje", ato mund të marrin vendim nëse duan ta marrin përsipër procesin e azilit të dikujt, edhe nëse personi ka hyrë në një vend tjetër të BE-së. Gjermania për shembull ka hequr dorë nga dorëzimi i refugjatëve në vende të tjera. Në verën e 2017-ës për shembull Gjermania nuk dërgoi më refugjatë mbrapsht në Hungari. Arsyja, mungesa e sigurisë ligjore. Komisioni i BE-së akuzoi Hungarinë se ia vështirësoi refugjatëve aksesin në proceset e azilit, në përshtatje me ligjet e BE-së.

Arsye të tjera për të hequr dorë nga Rregulli i Dublinit mund të jenë edhe dyshime në standartet sociale të vendeve të tjera të BE-së. Kështu për shembull Gjermania nuk kthente më refugjatë për në Itali, sepse atje ata nuk siste-



moheshin si duhej.

NDARJA E REFUGJATËVE

Me gjithë përjashtimet e bëra, Rregulli i Dublinit bën që shtetet anëtare që ndodhen në kufijtë e jashtëm të BE-së, të kenë të bëjnë me shifra të larta të numrit të refugjatëve. Prej kohësh bëhen përpjekje për të vendosur një kuotë shpërndarjeje të refugjatëve në mënyrë që të lehtësohen nga barra e rëndë shtetet si Italia dhe Greqia. Në raste krizash shtetet duhet të pranojnë një numër të caktuar refugjatësh, që vendoset në bazë të numrit të popullsisë së vet.

Një rregullim i tillë ka dështuar deri tani për shkak të kundërshtimit të disa vendeve. Polonia, Hungaria, Çekia dhe Sllovakia refuzojnë të marrin me detyrim refugjatë, që "iu caktohen t'i marrin. Më 2017 Bashkimi Europian u përpoq që me anë të një "Relocation Program", të rishpërndante në vende të tjera të BE-së, 160 mijë refugjatë që ndodheshin në Greqi dhe Itali. Por vetëm 26 mijë prej tyre u pranuan vërtet në vende të tjera të BE.

KONTROLLE KUFITARE NË ZONËN E SHENGENIT

Zona e Shengenit nuk është e njëjtë me zonën e BE-së. Jo të gjitha vendet janë anëtare të zonës së Shengenit, si për shembull Bullgaria dhe Rumania. Ndërkohë disa vende që nuk janë vende anëtare të BE-së, por janë anëtarë të zonës së Shengenit, si për shembull Islanda dhe Norvegjia. Brenda zonës së Shengenit njerëzit mund të lëvizin të lirë. Por ky rregull nuk është gjithnjë i vlefshëm.

Në kuadër të krizës së refugjatëve në vitin 2015, Gjermania futi kontrollin kufitar në zonën e Shengenit për të penguar mundësinë që një numër i madh refugjatësh të futeshin në Gjermani pa u kontrolluar asnjëherë për dokumentet. Kontrollat lejohen vetëm në situata emergjente dhe për afat të shkurtër, por Gjermania e shtoi gjithnjë e më shumë këtë afat, së fundmi në nëntor 2017. Ndërkohë qeveria gjermane e arsyeton kontrollin kufitar me rrezikun e sigurisë publike dhe rrezikut nga terroristi.

AKOMODIMI I REFUGJATËVE

Në çështjen e trajtimit të refugjatëve që presin përgjigje për kërkesën e azilit, vendimtare është si i interpretojnë ligjet e BE-së vendet anëtare. Disa aspekte janë të përcaktuara strikt, si, për shembull futja në tregun e punës e azilkërkuessve është e lejuar vetëm pas nëntë muajsh.

Rregullime të tjera nuk kanë formulime strikte. Sipas të drejtës ndërkombëtare të refugjatëve duhet të ekzistojnë kushte pranimi në përshtatje me të drejtat e njeriut. Se si duhet të jenë ato kushte, vendet e vendosin vetë. Prandaj mënyrën se si akomodohen refugjatët, standartet e vendeve të ndryshme të BE-së, janë shumë të ndryshme.

Kështu për shembull në disa vende ka kampe të mbingarkuara me refugjatë, ndërtesa pa pajisje sanitare ose madje në disa vende nuk janë të rralla çadra për refugjatët. Situata të tilla Gjermania i ka marrë si shkas për të hequr dorë nga rregulli i Dublinit dhe për të mos i kthyer refugjatët në këto vende.

← numrit të individëve që duan të kontribuojnë në zvogëlimin e konsumit të muzikës ligjërisht edhe pse pirateria në këtë fushë përfaqësohet me 23%. Vlen të përmendet rritja e raportit të konvertimit në muzikë nga 7% në vitin 2016, në 10% në vitin 2017, kështu që pavarësisht uljes së piraterisë, humbja në fitime vazhdon të rritet. Numri i konsumatorëve që kanë akses në përmbajtje e paligjshme është ulur nga 26% në 2016 në 22% në vitin 2017.

FILMAT

Përkundër rritjes së konsiderueshme të ruajtjes së të drejtës së autorit në përdorim të

filmave, përqindja e piraterisë në internet, vazhdon të jetë mesatarisht deri në 34%. Kapaciteti i filmave që u aksesua në mënyrë të paligjshme gjatë vitit 2017 ishte 726 milionë, me një vlerë tregu prej 5.725 miliardë euro, krahasuar me 6.935 miliardë euro në vitin 2016. 35% e qasjeve ndodhën ndërkohë që filmi ishte ende në ekranet në kinematë kinema, ndërkohë që kjo përqindje ishte 33% në vitin 2016.

SERIALET TELEVIZIVE

30% e përdoruesve kanë akses të paligjshëm në serialet televizive, duke përmblodhur 945 milionë episode që luhen ilegalisht ose janë shkarkuar gjatë vitit 2017. Vlera e tyre e tregut është 1.405 miliardë

euro. 46% e aksesueshmërisë ka ndodhur gjatë periudhës që episodo ende shfaqeshin në ekranet e televizioneve (39% në vitin 2016).

LIBRA

24% e përdoruesve të internetit shkarkojnë libra në formatin dixhital nga platformat e paligjshme, prandaj në vitin 2017 u llogariten 419 milionë ndërhyrje të paligjshme dixhitale në libra me një vlerë tregu prej 3.609 miliardë euro. Më shumë se 41% e aksesueshmërisë materializohen në përmbajtje të botuar në më pak se një vit më parë.

FUTBOLL

16% e përdoruesve të internetit i ndjekin ndeshjet e futbollit në

kanale të paligjshme. Prandaj, gjatë 2017, 113 milion ndeshje futboll janë parë ilegalisht në 10% të familjeve spanjolle, si dhe në 2016.

Masat që priten të merren

Masat më efektive kundër piraterisë do të ishin: bllokimi i aksesit në përmbajtjen e faqes dhe penalizimi i ofruesve të internetit. Pas këtyre dy masave, më e mira për të reduktuar shkëlqet do të ishte promovimi i fushatave ndërgjegjësuese sociale kundër piraterisë; kjo sugjeron që rritja e bashkëpunimit midis sektorit të përmbajtjes dhe ofruesit të shërbimeve të internetit (ISP) të mund të gjejë mbështetje tek konsumatorët, natyrisht së bashku me një vlerësim pozitiv.

HOROSKOPI

DASHI

Për shkak të ndikimit jo të favorshëm të Uranit nuk duhet të humbni nëpër hollësi, por duhet të përqendrohuni në esencën e gjërave. Organizohuni! Vazhdoni lëvizja favorizuese e Jupiterit, e cila premon ndryshime pozitive dhe krijese në jetë.

DEMI

Bashkëpremi i Hënës me Venusin do të bëjë që sot të kaloni një ditë të shumë bukur dhe të frytshme. Gjithçka do t'ju duket e thjeshtë. Do të kenë harmoni edhe në fushën e dashurisë. Është dita ideale për të kaluar kohën me miqtë ose me familjen. Përfiton!

BINJAKET

Tensionet e lidhura me probleme profesionale do të lehtësohen vetëm nga ëmbëlsia e personit të zemrës, që sot do të jetë më e theksuar. Nuk ndiheni të vetë brenda vetes sepse nuk arrini të zgjidhni midis dy pretendentësh që ju kanë magjepsur.

GAFORJA

Ditën e sotme, pasiguria dhe xhelozia në çift mund të shfaqen në formën e grindjeve. Me Venusin që ju mbështet, nëse punoni në fushën e artit ose spektakleve, parashikohen rezultate që ju përmbushin shpirtërisht dhe ju kënaqin nga ana materiale.

LUANI

Nuk është e habitshme që të jeni disi nervoz! Më Hënën që ju shqetëson, ju duket se çdo gjë shkon keq. Në fakt gjërat po shkojnë shumë mirë. Rrini me njëzëri me të cilët kuptohen dhe shmangni ata që paragjykojnë këdo dhe gjithçka.

VIRGJERESHA

Për meritë të Hënës dhe Jupiterit, sot do t'ia dini të përgatiteni në mënyrë efektive për të ndjekur objektivat me vendosmëri. Bisedoni me partnerin: mund të keni mbetur disi të ndarë nga njëri-tjetri nga zgjedhjet e juaja të fundit. Jini të kuptueshëm.

PESHORJA

Do të keni një dëshirë të fortë për të bërë të lëvizur rutinën e të përditshmeve. Të bëni disa ndryshime risie do t'ua bëjë gjithçka më të lehtë dhe të pëlqyeshme. Nëse mundni largoni ata që ju duken shumë sipërfaqësorë dhe që ju i gjykojnë jo shumë të besueshëm.

AKREPI

Me Plutonin aleat dhe Saturnin bashkëpunues, dhuntitë tuaja intelektuale do të shkëlqojnë për t'ju çuar përpara. Shmangni një mik të pavendosur. Me ndihmën e Saturnit, do të dini, ditë pas dite, të ndërtoni atë që keni për zemër.

SHIGJETARI

Saturni ju jep shumë energji. Kjo është ideale për të dalë për t'u argëtuar me miqtë, por edhe për të ushtruar sporte të ndryshme. Do të dini, gjithashtu, edhe të gjeni një mes të artë midis dashurisë dhe punës, duke fituar adminin nga të gjithë.

BRICJAPI

Nëse vazhdoni të jeni ende beqarë, ndoshta do të krijohen kushte favorizuese për të bërë takime premtuese. Duke u dhënë më shumë hapësirë hobive dhe krijtarisë suaj, do të jeni më të gatshëm për të ndihmuar edhe persona që ju rrethojnë.

UJORI

Të acaruar nga Neptuni në qiellin tuaj që grindet me Hënën, këtë ditë do të shfaqin anën më kryqëritëse të karakterit tuaj. Nëse do të mendoni me qetësi do ta kuptoni se askush nuk po e kërcënon realitetin tuaj të dashurisë.

PESHQI

Me Merkurin, Venusin, Marsin dhe Jupiterin bashkëpunorë, do të ndihni shumë të sigurt në vetvete dhe të atë për të pasur projekte largpamëse. Shijoni këtë ditë të bukur dhe ndryshoni rutinën, duke përfutur kështu edhe gjatë javës.

Mallkimi ndodh sërish

Meksika shtang Kampionët e Botës, Gjermania bie para kundërsulmeve

Meksika ka habitur të gjithë duke marrë një fitore spektakolare kundër Gjermanisë, e cila nis në mënyrën më të keqe të mundshme mbrojtjen e titullit në Kupën e Botës. Meksikanët fitojnë 1-0 në një ndeshje fantastike, me një lojë të hapur dhe tepër të shpejtë, duke vënë në vëshirësi të madhe gjer-

manët e duke mos i lënë pothuajse fare hapësira sidomos në pjesën e parë. Në pjesën më të madhe të kohës skuadra e Joachim Low ishte e paorganizuar, pa ide të qarta në sulm dhe tepër e brishtë në prapavijë, duke u lejuar shumë hapësira Meksikës. Dhe dhjetë minuta para fundit të pjesës së parë ishte Hirving Lozano që kaloi

topin pas shpinës së Neuer duke bërë të shpërthejnë në delir tifozët meksikanë, ndërsa trajneri Osorio qëndronte i ulur në stol duke mos i besuar syve. Pak minuta më vonë Toni Kroos pati një mundësi të artë për të barazuar, por goditja e dënimit e ekzekutuar mjeshhtërisht prej tij u grushtua nga Ochoa dhe u përplas në traversë. Në



pjesën e dytë Gjermania është më kërkuese në sulm por sërish pa ide dhe me Ozil dhe Kroos të mbuluar mirë nga lojtarët meksikanë. Çerek orë pas fillimit të pjesës së dytë Sami Khedira i lë vendin Marco Reus, me Low që kërkon të presojë më shumë në sulm. Prania e yllit të Dortmund në fushë i jep më

tepër forcë kampionëve të botës në fuqi. Me kalimin e minutave Meksika tërhiqet gjithnjë e më shumë ndërsa gjermanët arrijnë ta çojnë topin deri pranë zonës së Ochoas, por pa e gjetur rrjetën. Kroos, Draxler dhe Muller i afrohen shumë golit, por pa e gjetur. Dhjetë minuta nga fundi

vjen edhe shansi i Mario Gomez, veteranit që zëvendëson mbrojtësin Plattenhardt, për të shtuar forcat në sulm. Por hedhja përpara lë dy herë zbuluar mbrojtjen gjermane që shpëton pa pësuar golin e dytë vetëm falë mungesës së cilësive dhe përvogësive lojtarëve meksikanë. Fitorja tani është detyrim për gjermanët në dy ndeshjet e tjera të grupit kundër Suedisë dhe Koresë së Jugut nëse nuk duan të pësojnë fatin e Italisë në vitin 2010 dhe Spanjës në vitin 2014, që pasi kishin fituar Botërorin e kaluar, në ato edicione nuk kaluan as grupin.

Serbia mposht Kosta Rikën. Ndeshjen e vendosi goli i mrekullueshëm i kapitenit Kolarov

Shqiptarët e Zvicrës ndalin Brazilin dhe Neymarin

Shënon Coutinho, barazoi Zuber me asist të Shaqirit

Jeton Selimi



Zvicra ka befasuar Brazilin në "Rostov Arena", duke marrë një pikë me shumë vlera kundër një ekipi pretendent në takimin që u mbyll 1-1. Brazili e nisi mjaft mirë ndeshjen duke kaluar që në fillim në avantazh, por nuk arriti të menaxhonte rezultatin me Zvicrën që barazoi dhe e ruajti këtë rezultat deri në fund të ndeshjes, pavarësisht insistimit të "Selecao". Edhe pse shihen si ekip favorit për të fituar trofeun, Brazili nuk arriti të dilte me tri pikë nga kjo përballje. Ndeshja nisi me Zvicrën në sulm, që çuditërisht vë në rrezik në pesë minutat e para Brazilin, por vetëm kaq. "Selecao" i afrohet golit pas një aksioni dehës. Neymar pason në zonë për Paulinho, i cili provoi me një goditje diagonale, por sfera përfundoi ngjitur me shtyllën e djathtë të portierit (11). Pas 6 minutash "Selecao", i afrohet sërish golit me anë të Gabriel Jesus, por Sommer pret pa vëshirësi. Coutinho kaloi Brazilin në avantazh pas një gjuajtjeje të shkëlqyer nga hyrja e zonës duke shënuar një nga golat më të bukur deri më tani të këtij Botërori. Zvicra vuan shumë në këto minuta, me "Selecao", që nuk e ul ritmin për asnjë minutë. "Helvetët", rrezikojnë vetëm nëpërmjet



goditjeve standarde, pasi loja kontrollonhet nga kundërshtarit. Në të 37-tën Zvicra, pati një mundësi të mirë për të barazuar ndeshjen, por Seferovic, shpërdoroi një rast mjaft të mirë. Thiago Silva i afrohet golit në minutën e fundit të kësaj pjese pas një goditje këndi, por topi përfundon mbi traversë. Një moment përgjumjeje në mbrojtjen e Brazilit dhe aty përfitoi Zuber, i cili me kokë e dërgoi topin në rrjetë pas krosit nga këndi të

Xherdan Shaqirit (50'). Ky ishte goli i katërt për të me kombëtaren zvicerane. Pas këtij momenti, Brazili rrit temin dhe e kërkon më me shumë dëshirë golin. Neymar dhe Coutinho kthehen në një kërcënim serioz për Sommer, i cili e mbron portën e tij me çdo kusht. Danilo provon me një goditje të fuqishme nga distanca, por sfera përfundon jashtë (66'). Coutinho i afrohet sërish golit pas një pasi nga Neymar, por ylli i Barcelonës

nuk ka shënjestrën e duhur (70'). Zvicra përgjigjet tre minuta më vonë me Xhemalin, por Alisson pret pa vëshirësi. Një minutë përpara fundit Firmino i shkon shumë afër golit pas një goditje me kokë, por Sommer largon me vëshirësi. Pavarësisht rasteve të rrezikshme nga të dyja skuadrat, ndeshja u mbyll në brazilin.

SERBIA FITON

Një goditje dënimi e ekzekutuar në mënyrë per-

fekte nga Aleksandar Kolarov, i dha Serbisë 3 pikë të arta në takimin parë në Grupin E kundër Kosta Rikës. Në një sfidë të luftuar, serbët ditën të mbroheshin mirë duke mos u lejuar hapësira rivalëve të Amerikës Qendrore dhe pas 100 minutash lojë në "Samara Arena" iu gëzuan 3 pikëve të marra. Kosta Rika ishte surpriza e botërorit të shkuar ku shkoi deri në çerekfinalin e kompeticionit dhe synon që të njëjtin sukses ta përsërisë edhe këtë herë. Por e nisën me humbje. Kolarov realizoi në të 56, ndërkohë që në pjesën e dytë me gjithë përpjekjet e kostarikanëve, goli nuk erdhi. Pasi Aleksandar Mitrovic u rrëzua pas një faulli nga David Guzman, mbrojtësi i Romës, goditi saktë nga 23 metra. Rasti më i mirë për Kosta Rikën ishte nga Giancarlo Gonzalez pak minuta nga nisja e takimit me kokë. Kombëtarja nga Amerika Qendrore hodhi në fushë formacionin me mesataren më të lartë të moshës, 29 ditë e 346 ditë.

BOTEROR RUSI 2018		
Grupi E		
Kosta Rika - Serbi	0-1	
Brazil - Zvicër	1-1	
Renditja		
Skuadra	N	P
Serbia	1	3
Brazili	1	1
Zvicra	1	1
Kosta Rika	1	0
Grupi F		
Të dielën		
Meksikë - Gjermani	1-0	
Të hënën		
Suedi - Kore e Jugut	14:00	
Renditja		
Skuadra	N	P
Meksika	1	3
Kore e Jugut	0	0
Suedi	0	0
Gjermani	1	0

TRAJNERI I GJERMANISË

Lwv: Gjithsesi do ta kalojmë grupin

Joakim Lwv i pyetur rreth mallkimit të tre botërorëve të fundit ku skuadra kampione nuk arrin të kalojë grupin, ka thënë "se nuk kam dijeni për një fakt të tillë, por sigurisht ne nuk do të na ndodhë kjo gjë. Do ta kalojmë grupin". "Natyrisht që është zhgënjyese të humbasësh ndeshjen e parë

të grupit dhe ne nuk jemi mësuar me dëkta të tillë. Zakonisht i fitojmë, por duhet të adaptohem. Do të korrigjohemi në dy ndeshjet e radhës. Jemi nën presion. Në pjesën e dytë u rritim shumë pasi në pjesën e parë luajtëm keq. Ishim nervozë, nuk kri-

jonim hapësira dhe nuk dublonim në mbrojtje. Meksikën e prisim të tillë, por nuk do të ndërrojmë mënyrën tonë të lojës që t'u përshtatemi rivalëve, nëse do të luanim ashtu siç dimë ne të luajmë, do t'i kishim mundur".

TRAJNERI I MEKSIKËS

Osorio: E merituar, ishim superiorë


Huan Karlos Osorio, trajneri i Meksikës, është shumë i lumtur për fitoren, por pavarësisht suksesit, ai pranon supremacinë e Kampionëve të Botës. "Kishim një plan dhe kemi gjashtë muaj që punojmë për këtë plan. Për shkak të dëmtimeve nësh të dashur të ndërronim disa lojtarë. Në pjesën e parë ishim vendosur shumë mirë në prapavijë dhe kemi kundërsulmuar



shumë shpejt. Me gjithë respektin që kam për ekipin e madh të Gjermanisë, në

pjesën e parë ishim superior. Edhe ata patën manovrat e tyre sulmuese, por ne punuam më mirë me mesfushën dhe me mbrojtësit tanë. Lojtarët me eksperiencë ndërkombëtare ndihmuan të rinjtë. Ne luajtëm me dashurinë për lojën dhe jo me frikën e humbjes".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufji.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Është Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotuarët.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë .
- Preka komik shkordran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë

- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.
- Është përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Është e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë .
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Është nja që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

VERTIKAL

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Është metri i rrobaqepësit.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stili të lirë .
- Ishin monedhë te Tobias.
- Është bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Është marrëveshje me nota.
- Ishite babai e Akilit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Është faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Është shtet aziatik.
- Edouard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Unë i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Është ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.


- Ente Ekonomike Sarandë.
- Mbyllin një ditar.
- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Është kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Maureen që qe aktore.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Është tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.

VERTIKAL


- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Është edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufji.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inicilat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Është trysni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreaun aktore.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

6	5	9						
			1	7				
								3
6		3			1			
			4		9	6		
3	8			6	4	7		
2	7						1	
			1			4	6	
			9	5	8			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	7	6	8	9	1	4	5	2
4	8	9	2	5	6	3	1	7
1	2	5	3	4	7	8	9	6
9	3	4	7	6	5	1	2	8
5	1	7	9	8	2	6	3	4
2	6	8	1	3	4	9	7	5
6	5	2	4	1	3	7	8	9
7	9	1	6	2	8	5	4	3
8	4	3	5	7	9	2	6	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Ekzistojnë dy ditë në vit që nuk mund të bësh asgjë: njëra quhet "dje" dhe tjetra "nesër".
Prandaj e sotmja është një ditë e përshtashme të duash, të besosh dhe kryesisht të jetosh !!!
- Shpirti melankolik rrit mjerinë, ndërsa një buzëqeshje e lumtur shpesh shpërndan mjegullën që predikon stuhinë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	7	2		7	3		13		2	
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6
		3	5	8	2	3	5	6	1	7	5
12	5	13	5	10	1	7		6		13	
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6
8	2	6	2		2		1	8	5	11	1
1	6	8		17	9	5	7	2		9	
5	1	5		8	2	16			2	7	1
2			3	2	6	5	9	2		1	13
6	2	7	2			3	7	18	18	6	7
3	4	8	5	19	1	5		3	5	2	

PËRÇJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	L	E	X	S	G	P	O	A	Z	I		
M	T	S	H	N	D	O	R	E	S	H	K	
M	A	R	A	M	O	G	O	A	U	T	O	
M	K	I	M	N	O	V	A	K	O	N	I	
P	S	E	R	I	A	L	I	A	R	T	I	
T	R	E	T	E	N	D	I	M	I	O	K	
P	R	O	N	A	L	D	O	T	G	A	E	
M	A	L	E	N	G	A	T	E	R	O	R	
B	A	T	A	R	I	A	T	E	R	O	R	
I	R	O	N	A	C	E	M	Y				
L	I	R	I	K	E	P	A	R	O	D	I	A
L	O	T	R	A	C	O	R	O	T	K	N	

FJALËKRYQI (1)

F	A	L	L	I	K	F	S	D	O	R	A	
A	D	A	M	P	A	L	L	I	M	I	N	
L	E	M	L	E	A	B	E	L	L	A	T	T
A	T	K	A	P	I	T	U	L	L	I	M	I
N	G	M	A	R	I	N	A	R	I	A	R	I
G	R	E	M	I	N	A	U	E	F	I	E	
A	R	I	F	D	E	N	T	I	S	T		
P	E	T	K	A	T	E	S	E	R	E		
C	I	T	A	T	E	M	E	T	O	R	E	
O	S	Z	R	A	M	T	R	E	T			
S	H	T	E	P	I	T	E	L	E	J	A	
A	E	K	A	M	I	V	I	S	A	R	I	

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mëncura

- Nëse jeni duke kërkuar për një mik, do të zbuloni se është e vështirë për të gjetur. Nëse je i gatshëm të jesh mik, do t'i gjeni ata kudo.
- Shëmnia është superior ndaj bukurisë.
- sepse ajo zgjat më shumë.
- Martesa është mrekullia që transformon puthjen nga kënaqësi në detyrë.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

